




USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

The Kosovo Municipal Competitiveness Index Report 2011
Raporti i Kosovës për Indeks in e Konkurrencës në Komuna 2011
Izveštaj o Indeksu Konkurencije u Kosovskim Opštinama 2011



Business Enabling Environment Program
Programi për Përmirësimin e Mjedisit Afarist
Program za Poboljšanje Poslovnog Okruženja

<http://www.usaidbeep.org/>
info@usaidbeep.org

PROGRAMI PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT AFARIST

INDEKSI I KONKURRENCËS NË KOMUNAT E KOSOVËS 2011

MATJA E QEVERISJES EKONOMIKE PËR ZHVILLIMIN E
SEKTORIT PRIVAT

30 QERSHOR, 2011

30 Qershor, 2011

Ky botim është prodhuar për rishqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ai është përgatitur nga Chemonics International Inc. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LISTA E TABELAVE.....	4
LISTA E FIGURAVE	5
FALËNDERIME.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. MJEDISI AFARIST NË KOSOVË: IMPERATIVI PËR VLERËSIM	9
2. PORTRETI I BIZNESIT	16
3. VLERËSIMI I IKK 2011: SHPJEGIME DHE ANALIZA.....	20
4. REZULTATET E IKK SIPAS NËNINDEKSIT	28
5. MJEDISI I AFARIZMIT KOMBËTAR DHE KORRUPSIONI	59
6. METODOLOGJIA.....	65
SHTOJCAT	72
SHTOJCA 1: Përshkrim i detajuar i nënindekseve dhe Treguesve të Komponentit	72
SHTOJCA 2: Renditja e IKK së jo të ponderuar.....	73
SHTOJCA 3: Analiza e shumëfishtë e regresionit e Qeverisjes dhe Bizneseve të Reja.....	75
SHTOJCA 4: Rezultati i komunave sipas nënindeksit dhe treguesit	77
SHTOJCA 5: Popullimi i biznesit dhe madhësia e mostrës sipas komunave.....	85
REFERENCAT	87

SHKURTESAT

ABK	Aleanca e Bizneseve Kosovare
BEEP	Programi për përmirësimin e afarizmit (Business Enabling Environment Program)
CPI	Indeksi i Transparency International për Perceptimin e Korrupsionit
IQE	Indeksi i Qeverisjes Ekonomike
IHD	Investimet e Huaja Direkte
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
IKK	Indeksi i Konkurrencës në Komuna
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla, dhe të Mesme
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (United States Agency for International Development)
BB	Banka Botërore

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1: Tetë nënindekset e IKK	14
Tabela 1.2: Analizë e dizajnit të IKK	15
Tabela 2.1: Analizë e Bizneseve të Kosovës dhe respondentëve të IKK	16
Tabela 2.2: Pronarët e bizneseve sipas gjinisë	18
Tabela 3.1: Vlerësimi i nënindeksit	20
Tabela 3.2: Rezultatet e komunave serbe veriore	26
Tabela 4.1: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e barrierave për nisjen e biznesit	32
Tabela 4.2: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e transparencës	36
Tabela 4.3: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e parashikueshmërisë dhe pjesëmarrjes	40
Tabela 4.4: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e kostos së kohës	43
Tabela 4.5: Të hyrat vetanake komunale	43
Tabela 4.6: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e Taksave dhe Tarifave	47
Tabela 4.7: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e administratës komunale	50
Tabela 4.8: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e shërbimeve mbështetëse të biznesit dhe punës	54
Tabela 4.9: Indikatorët që përfshijnë nënindeksin e infrastrukturës komunale	58
Tabela 5.1: Koha dhe kostot monetare të Treguesve të	60
Tabela 5.2: Përgjigjet e mundshme të rreme dhe Vlerësimet e mos-përgjigjeve sipas komunës	62
Tabela 5.3: Vlerësimet e njësisë së mos-përgjigjeve sipas komunës	63
Tabela 5.4: Vlerësimet e njësisë së mos-përgjigjeve sipas komunës	63
Tabela 6.1: Vlerësimet e nënindeksit	70

LISTA E FIGURAVE

Figure 2.1: Totali i bizneseve aktive sipas subjektit ligjor	17
Figure 2.2: IKK të Bizneseve sipas numrit të të punësuarve	17
Figure 3.1: Vlerësimi final i IKK për 2011	22
Figure 3.2: Renditja e IKK-së së vlerësuar për 2011 me intervalet e besimit	24
Figure 3.3: Rezultatet e nënindeksit të vlerësuar të IKK sipas komunës	25
Figure 3.4: Marrëdhëniet ndërmjet qeverisjes dhe ndërmarrjeve të reja	26
Figure 4.1: Regjistrimi i biznesit në komunë dhe dita e regjistrimit	29
Figure 4.2: Vlerësimi i indeksit të barrierave për nisjen e biznesit	30
Figure 4.3: Nënindeksi i barrierave për nisjen e biznesit me 95% të Intervaleve të Besimit	31
Figure 4.4: Vlerësimi i nënindeksit të transparencës	34
Figure 4.5: Nënindeksi i transparencës me 95% të Intervaleve të Besimit	35
Figure 4.6: Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria	37
Figure 4.7: Vlerësimi i nënindeksit të pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë	38
Figure 4.8: Nënindeksi i pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë me 95% të Intervaleve të Besimit	39
Figure 4.9: Kostoja kohore vlerësimit të nënindeksit së pajtueshmërisë rregullatore	41
Figure 4.10: Nënindeksi i kostos kohore me 95% të Intervaleve të Besimit	42
Figure 4.11: Korrelacioni ndërmjet Negocimeve për Taksa Informale dhe Taksave si Pengesa të Biznesit	44
Figure 4.12: Vlerësimi i nënindeksit të taksave dhe tarifave	45
Figure 4.13: Nënindeksi i taksave dhe tarifave me 95% të Intervaleve të Besimit	46
Figure 4.14: Vlerësimi i Nënindeksit të Administratës Komunale	48
Figure 4.15: Nënindeksi i Administratës Komunale me 95% të Intervaleve të Besimit	49
Figure 4.16: Renditja e Nënindeksit të Shërbimeve Mbështetëse të Biznesit dhe Punës	52
Figure 4.17: Nënindeksi i Shërbimeve Mbështetëse të Biznesit dhe Punës me 95% të Intervaleve të Besimit	53
Figure 4.18: Vlerësimi i nënindeksit të infrastrukturës komunale	56
Figure 4.19: Nënindeksi i infrastrukturës komunale me 95% të Intervaleve të Besimit	57
Figure 6.1: Krijimi i nënindeksit	69

MIRËNJOHJE

Indeksi i Konkurrencës të Komunave të Kosovës për 2011 (IKK) është një komponent i veçantë i projektit për Përmirësimin e Mjedisit Afarist në Kosovë në kuadër të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID/BEEP), i menaxhuar nga Chemonics International Inc. Puna në terren e IKK është kryer nga UBO Consulting, Prishtinë.

Natasha Hanshaw nga Blue Crest Group LLC ka udhëhequr zhvillimin e metodologjisë së IKK-së dhe ka hartuar raportin e IKK 2011

IKK 2011 është rezultat i bashkëpunimit substancial në mes të shumë individëve. Natasha Hanshaw u mbështetur gjatë gjithë procesit me këshilla të ekspertëve teknik dhe inputi metodologjik nga Dr. Edmund Malesky i Universitetit të Kalifornisë, San Diego, si dhe ka marrë inpute të ekspertëve dhe mbështetje kërkimore nga i tërë ekipi i BEEP Kosova. Ndiha në anketim në lidhje me të dhënat e anketës së IKK është dhënë nga Fatima Frank i Universitetit të Kalifornisë, San Diego.

IKK është zhvilluar nën udhëheqjen e përgjithshme të Kryesuesit të Projektit USAID/BEEP, Terry Slywka.

Hulumtimi në terren është kryer nga UBO Consulting nën udhëheqjen e Uliks Osmanit dhe Menaxherit të Kontrollit të Cilësisë, Berat Abdiu, të ndihmuar nga ekipi i ekspertëve të shkëlqyer të kompanisë së tyre.

Kjo ishte anketa e parë dhe më e madhe e biznesit e llojit të saj në Kosovë, e cila nuk do të kishte qenë e mundur të realizohej pa përkushtimin dhe përsosmërinë e ekipeve në terren nga UBO Consulting, të cili kanë punuar shumë për të kryer anketën e biznesit. Përkushtimi i tyre ishte i domosdoshëm për të futur në listë pjesëmarrjen e sipërmarrësve të zënë dhe thelbësor për anketimin e sipërmarrësve në komunat serbe të veriut të Kosovës.

Në fund, ne duam të falënderojmë 2.026 sipërmarrësit të cilët u pajtuan që një pjesë të kohës së tyre të zënë t'ia kushtojnë intervistës për afërsisht prej 45 minutash dhe të kontribuojnë që të kuptohen më mirë mjediset afariste me të cilat ata përballen çdo ditë. Gatishmëria e tyre për të marrë pjesë në këtë përsëritjen e parë të IKK-së përcakton fazën për IKK dhe kontributin e tyre në përmirësimin e mjedisit të biznesit në tërë Kosovën.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi afatgjatë ekonomik kërkon një sektor të fortë dhe të shëndetshëm privat. Në Kosovë, si në shumë ekonomi në lindje dhe në zhvillim e sipër, ky motor i rritjes janë ndërmarrjet formale dhe joformale mikro, të vogla, të mesme të sektorit privat (NMVM), ku ekziston burimi kryesor i punësimit.

Ndonëse politikat kombëtare janë kritike për sa i përket klimës ekonomike në vend, bizneset, sidomos NMVM-të, duhet kryesisht të merren me komunën e tyre lokale, dhe për çdo ditë janë më të prekura nga mjedisi i biznesit lokal në të cilin ato operojnë. Në pjesën jugore të Kosovës, në Prizren, pronari i një kompanie të madhe të përpunimit të ushqimit shpjegon si vijon: "Në komunën time, ka një mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar – mua më duhet të trajtojë të punësuarit rinj, por ata pasi që trajnohen e lënë punën tek unë duke kërkuar punë më të mirë. Kompania ime paguan një çmim të madh për shkak të fuqisë punëtore të patrajtuar. "Në Mitrovicë, pronari i një tjetër kompanie për eksportimin e ushqimit të përpunuar ankohet për kostot e transportit të shkaktuara nga infrastruktura e dobët e rrugëve lokale të komunës për të transportuar produktet në rrugët kryesore dhe në tregje. Ashtu siç sugjerojnë këto pohime, mjedisi i biznesit në komunat luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen ose ngufatjen e rritjes së biznesit. Në të vërtetë, ndryshimet në cilësinë e qeverisjes ekonomike në të gjitha komunat kontribuojnë në nivelet e pabarabarta të rritjes ekonomike dhe mundësitë e biznesit në mbarë Kosovën. Si e tillë, ekziston nevoja për të kuptuar më mirë ndërveprimin e biznesit me pushtetin lokal dhe variacionin në cilësinë e qeverisjes në mesin e komunave.

Në këtë kontekst dhe në kuadër të decentralizimit të Kosovës, duhet të lëvizet përpara drejt qeverisjes më të madhe lokale pas pavarësisë në vitin 2008, ku një analizë rigoroze dhe portretizimi i qeverisjes nën-kombëtare ekonomike dhe mjedisit rregullator të biznesit mund të japin informacion të domosdoshëm për të përmirësuar performancën ekonomike. Në të vërtetë, me vëmendjen e fokusuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, ekziston një domosdoshmëri për vlerësimin dhe kuptimin e faktorëve të qeverisjes që mund të krijojnë një përmirësim të mjedisit afarist brenda Kosovës.

Për këtë qëllim, përsëritja vjetore e Indeksit të Konkurrencës së Komunave të Kosovës (IKK) paraqet të dhëna të besueshme vjetore mbi mjedisin afarist (të biznesit) në të gjitha komunat në Kosovë, duke u bazuar në përvorjet e drejtpërdrejta dhe rrethanat më të cilat përballen bizneset lokale. IKK rendit qeverisjen ekonomike të komunave duke pasur si qëllim kryesor përmirësimin e produktivitetit dhe performancës së biznesit privat, duke identifikuar dhe zvogëluar kufizimet e ndikuara nga qeveria për zhvillimin e sektorit privat në nivel nën-kombëtar, të tilla si pengesat e dëmshme rregullatore, korrupsioni, dhe paqartësia në mjedisin ligjor.¹

IKK e Kosovës mbështetet fuqimisht mbi metodologjinë gjerësisht të suksesshme të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike Lokale (IQL), një mjet i specializuar dhe

¹ Shih Malesky (2008).

metodologjikisht rigoroz i hartuar për të matur cilësinë e qeverisjes ekonomike lokale, vlerësimin e progresit me anë të një sërë treguesish sasiorë përgjatë një afati kohor, si dhe të mbështes reformën e politikave. Indeksi është një koleksion i treguesve që mbështeten kryesisht në perceptimet e pronarëve të bizneseve që më pastaj janë standardizuar në një shkallë vlerësuese prej 10 pikësh dhe që përdoren për ndërtimin e nën-indekseve përkatëse teorike (kategorive). Këto indekse janë përvijuar më pas në një indeks final të politikave relevante. Duke përdorur këtë metodologji rigoroze si bazë, IKK është përshtatur me kujdes për të pasqyruar rrethanat unike në Kosovë.

IKK është ndërmarrja e parë në shkallë të gjerë e këtij lloji në Kosovë, e zbatuar në të gjitha 37 komunat dhe duke reflektuar përvojat e drejtpërdrejta të 2.026 bizneseve të zgjedhura rastësisht në lidhje me aspektet e ndryshme të mjedisit lokal të biznesit të tyre dhe të qeverisjes lokale. Vargu i hartuar i treguesve paraqet një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi të niveleve të performancës së autoriteteve komunale në tetë dimensionet e qeverisjes vendore: 1) Pengesat për nisjen e biznesit, 2) Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria, 3) Transparenca dhe qasja në informata, 4) Kostoja e kohës, 5) Taksat dhe tarifat, 6) Administrata komunale, 7) Puna dhe shërbimet mbështetëse të biznesit, dhe 8) Infrastruktura komunale.

Të dhënat e IKK dhe informacionet që janë krijuar ofrojnë për politikë-bërësit një mjet për monitorimin e performancës dhe qeverisjes ekonomike në tërë vendin. Për të qenë të sigurt, përmirësimet në IKK janë lidhur me përmirësimet në mjedisin e biznesit: Përmirësimet në qeverisje ekonomike ashtu siç janë matur nga IKK janë lidhur pozitivisht me bizneset e reja për kokë banori dhe planet e biznesit për investime në dy vitet e ardhshme. Më tej, marrëdhëniet dhe ndikimi më i madh në performancën e sektorit privat qëndron në transparencën dhe koston e ulët të kohës së pajtueshmërisë, të matur me IKK.

Në vendet e studiuara më parë, përmirësimet në qeverisjen ekonomike kanë një marrëdhënie të fortë pozitive me PBB për kokë banori, dhe Indeksi ka qenë i suksesshëm në nxitjen e reformës ekonomike.

Për komunat, IKK identifikon praktikën më të mira dhe variacionin në mjediset e biznesit në tërë vendin, duke hapur rrugën për komunat për të mësuar nga njëra-tjetra dhe të shkëmbejnë praktikën më të mira. Më tej, IKK do të jetë e dobishme për të monitoruar progresin në komuna.

Në nivel kombëtar, IKK mund të shërbejë si një mjet për planifikim strategjik për të lehtësuar bashkëpunimin dhe dialogun në mes qeverisë qendrore dhe lokale për përmirësimin e mjediseve lokale të biznesit në tërë Kosovën. IKK mund të përdoret gjithashtu nga ana e investitorëve të huaj të interesuar në Kosovë për të përcaktuar se ku duan të fokusojnë investimet dhe të marrin vendime të informuara. Së fundi, ajo plotëson mjetet kombëtare ekzistuese siç janë raportet e Bankës Botërore të Bërjes Biznes dhe sondazhet e ndërmarrësisë.

Për komunitetin e biznesit, IKK paraqet zërin e tyre në tryezën e politikë-bërjes dhe mund të përdoret nga bizneset që të avokojë për përmirësime në komunat e tyre.

Për donatorët ndërkombëtarë, IKK mund të përdoret si një mjet për identifikimin e objektivave të reja të projektit dhe monitorimi e ndikimit të projektit.

1. MJEDISI I BIZNESIT NE KOSOVË: IMPERATIV PËR VLERËSIM

Kanë kaluar diçka më shumë se 10 vite që nga përfundimi i luftës në Kosovë, kur Kombet e Bashkuara filluan misionin e parë dhe të vetëm ndërkombëtar të shtet-ndërtimit në botë. Gjatë 10 viteve të fundit, përpjekjet janë fokusuar në rindërtimin e institucioneve politike dhe ekonomike, institucionalizimin e paqes dhe stabilitetit, dhe ndërtimin e një kombi.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, agjenda e kombit të sapolindur ka lëvizur nga fokusimi kryesisht në zhvillimin politik institucional drejt zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike. Me rreth 15 % të PBB-së nga remitancat e diasporës, 7.5 % të PBB-së nga ndihma ndërkombëtare, PBB më të ulët kokë banori në Evropë prej 2.500 \$ US, shkallë e madhe e papunësisë që vlerësohet të jetë rreth 40 %, dhe popullatën më të re në Evropë e cila do të futet në tregun e punës gjatë viteve të ardhshme, zhvillimi ekonomik është bërë imperativë për të ardhmen e Kosovës.²

Zhvillimi afatgjatë ekonomik kërkon një sektor të fortë dhe të shëndetshëm privat. Në Kosovë, si në shumë ekonomi në zhvillim dhe të sapolindura, ky motor i rritjes, janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të sektorit privat formal dhe joformale (NMVM), i cili ofron ofron burimin kryesor të punësimit. Megjithatë, rritja dhe performanca e këtyre NMVM-ve janë të kufizuara shpesh nga një gamë e gjerë e pengesave rregullative.³ Në veçanti, qeveritë mund të pengojnë zhvillimin e sektorit privat nëpërmjet politikave dhe kërkesave të paqarta rregullative, qasjes së kufizuar në informata, dhe ofrimin e dobët të mallrave dhe shërbimeve publike. Përkundrazi, përmirësimet që janë të dobishëm për zhvillimin e sektorit privat përfshijnë rregullimet e strukturuar, një mjedis rregullator transparent dhe qasjen në informata, si dhe ofrimin e shërbimeve publike në kohën e duhur.

Aty ku qeveritë mund të sigurojnë kuadrin rregullator dhe mjediset e biznesit që inkurajojnë sipërmarrësit dhe zhvillimin e biznesit në përgjigje të stimujve bazuar të treg, shpërblimet janë zgjerimi i investimeve të sektorit privat, performanca e përmirësuar e sektorit privat, rritja ekonomike, krijimi i vendeve të punës, dhe në fund të fundit reduktimet në shkallës së varfërisë. Kur ekonomitë angazhohen globalisht për të tërhequr investime të huaja direkte, mjediset e fuqishme dhe mbështetëse të biznesit vjelin përfitimet e rritjes ekonomike dhe mundësitë e rritura të punësimit të cilat ofrohen nga investimet e huaja. Përmirësimet në qeverisjen ekonomike kombëtare dhe lokale kështu mund të ketë ndikim të madh në zgjerimin e biznesit, të punësimit, si dhe në nivelet e investimeve të brendshme dhe jashtme.⁴

Ndonëse politikat kombëtare janë kritike për klimën ekonomike në vend, bizneset, sidomos NMVM-të, duhet kryesisht të merren me komunën e tyre lokale, dhe në baza

² Shih CIA Libri i Fakteve në Botë - Kosovë (2010).

³ Shih Fondacionin Azia (2008). Më tutje, veni re se vetë IKK nuk përfshinë IHD.

⁴ Shih Malesky (2009), Kaufmann et al. (2007).

ditore janë më të prekura nga mjedisi i biznesit lokal në të cilin ata veprojnë dhe këto mund të ndryshojnë në mënyrë drastike nga komuna në komunë.

Në të vërtetë, modeli i Kosovës i rritjes ekonomike ka qenë mjaft i pabarabartë. Jashtë kryeqytetit, Prishtinës, shumica e popullsisë jeton në qytete rurale, ku është karakteristikë e zakonshme bujqësia joefikase afër nivelit të mbijetesës dhe puna joformale e përkohshme.⁵

Ky model i rritjes po i shtyn kufijtë e kapaciteteve dhe infrastrukturës urbane. Në të vërtetë, kapaciteti infrastrukturor i Prishtinës është duke u shkatërruar nga rritja e popullsisë që prej përfundimit të luftës, ndërsa ndërtimi i ndërtesave të reja po shkatërron rrugët e brishta anësore. Të rinjtë, në veçanti, vazhdojnë të zhvendosen në Prishtinë për shkak të perspektivës më të madhe për punë dhe qasje në arsimin e lartë.

Ky model i rritjes është larg nga të qenurit i qëndrueshëm. Si i tillë, ekziston nevoja për të kuptuar më mirë ndërveprimin e biznesit me qeverinë lokale dhe variacionin në cilësinë e pushtetit në mesin e komunave, për të aktivizuar potencialin ekonomik dhe zhvillimin e vendit si tërësi.

Ekzistojnë ndarje të thella ekonomike në tërë vendin: serbët e Kosovës që jetojnë në veri të lumit Ibër shprehin frustrimet nga mungesa e qasjes në tregjet e jashtme në jug të lumit Ibër, si dhe mungesa e kërkesës për mallrat e tyre dhe shërbimet në komnatat e tyre.⁶ Bujqësia mbetet profesion kryesor për shumicën e familjeve rurale në komnatat serbe, megjithatë, këta fermerë ankohen se ata nuk mund të shesin mallrat e tyre në vendbanimet shqiptare, ose përtej kufirit në Serbi për shkak të kostove shtesë të tregtisë së jashtme.⁷ Në disa komuna etnike serbe në jug të lumit Ibër, megjithatë, tregtia mbetet historikisht e fuqishme në mes të serbëve dhe shqiptarëve etnikë.⁸ Adresimi i modeleve të tregtisë dhe biznesit ndër-etnik në tërë Kosovën do të mund të ofronte të kuptuarit më të mirë të dinamikës së këtyre komuniteteve dhe shkallën në të cilën ata janë të integruar në një komunitet më të madh të biznesit në Kosovë. Për të qenë të sigurt, adresimi i pabarazive ekonomike dhe sigurimi i një terreni adekuat dhe të drejtë përgjatë etnive do të jetë domosdoshmëri për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të biznesit për të gjitha komunitetet.⁹

Në këtë kontekst një analizë rigoroze dhe portretizimi i qeverisjes nën-kombëtare ekonomike dhe mjedisit rregullativ të biznesit mund të japin informacione të domosdoshme për të përmirësuar performancën ekonomike. Në të vërtetë, ekziston në nevojë në rritje e sipër për vlerësimin dhe për të kuptuar politikat dhe rregullimet që mund të ndihmojnë përmirësimin e mjedisit afarist (të biznesit) brenda Kosovës.

Për këtë qëllim, përsëritja vjetore e Indeksit të Konkurrencës së Komunave të Kosovës (IKK) paraqet të dhëna të besueshme vjetore mbi mjedisin afarist (të

⁵ Misioni i OSBE në Kosovë (2010).

⁶ Intervistat e autorit me pronarët etnik serbë të ndërmarrjeve të vogla që jetojnë në veri të Mitrovicës dhe Zveçan, tetor 2010

⁷ Shih Deda dhe Gashi (2009).

⁸ Intervistat e autorit me banorët lokal në komunën e Gjilanit, Nëntor 2010.

⁹ Bhaumik, Gang, dhe Yun (2006).

biznesit) në të gjitha komunat në Kosovë, duke u bazuar në përvojat e drejtpërdrejta dhe rrethanat më të cilat përbullen bizneset lokale. IKK rendit qeverisjen ekonomike të komunave duke pasur si qëllim kryesor përmirësimin e produktivitetit dhe performancës së biznesit privat, duke identifikuar dhe zvogëluar kufizimet e ndikuara nga qeveria për zhvillimin e sektorit privat në nivel nën-kombëtar, të tilla si pengesat e dëmshme rregulatore, korrupsioni, dhe paqartësia në mjedisin ligjor.¹⁰

Tri çështje kyçe përbëjnë themelet e IKK dhe vlerën e saj për Kosovën në këtë kohë. Së pari, qeveria e Kosovës është fokusuar aktualisht në zhvillimin dhe ekzekutimin e një plani strategjik për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të ndihmuar rritjen ekonomike, si dhe formimin dhe ofrimin e një kornize për qeverisje të mirë.¹¹ Së dyti, një qasje bindëse dhe e vlefshme për të përmirësuar qeverisjen e Kosovës dhe rritjen ekonomike është që të krijohen mundësi për bizneset në mënyrë që ato të angazhohen në mënyrë më efektive në krijimin e politikave dhe procesin e monitorimit. Së treti, përpjekjet e reformës në nivel kombëtar dhe komunal mund të mbështeten duke siguruar të dhënat dhe informatat të cilat mund të përdoren nga hisedarët. Në të vërtetë, IKK mund të hapë rrugën për dialog në mes të nivelit qendror dhe lokal, duke shërbyer si një instrument për të identifikuar politikat për ministrinë e nivelit qendror.

INDEKSI I KONKURRENCËS SË KOMUNAVE: DIZAJNI DHE METODOLOGJIA

Indeksi i Konkurrencës në Komuna mund të ofrojë përfitime të jashtëzakonshme për Kosovën derisa ajo kërkon që të zbatojë programin e saj të reformave ekonomike dhe të nxjerrë potencialin e saj ekonomik. Ai ofron një zë dhe fuqizim të ndërmarrësve, duke krijuar stimuj dhe drejtime për reformën në mesin e zyrtarëve komunal dhe kombëtar. Si i tillë, përgjegjësia mbi krijuesit e Indeksit është e madhe për të siguruar që ai ofron një përshkrim të saktë të mjediseve lokale të biznesit. Një metodologji e shëndoshë është e nevojshme për të siguruar saktësinë e të dhënave dhe analizën që nënvizojnë rezultatet e IKK.

IKK është ndërmarrja e parë në shkallë të gjerë e këtij lloji në Kosovë, duke matur dhe vlerësuar standardet e qeverisjes të nxjerra nga përvojat dhe rrethanat e bizneseve. IKK 2011 është zbatuar në të gjitha 37 komunat e Kosovës dhe reflekton përvojat e drejtpërdrejta të 2.026 bizneseve të zgjedhura rastësisht në lidhje me aspektet e ndryshme të mjedisit lokal të biznesit të tyre dhe të qeverisjes lokale.

IKK e Kosovës mbështetet fuqimisht mbi metodologjinë gjerësisht të suksesshme të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike Lokale (IQE), një mjet i specializuar dhe metodologjikisht rigoroz i hartuar për të matur cilësinë e qeverisjes ekonomike lokale, vlerësimin e progresit me anë të një sërë treguesish sasiorë përgjatë një afati kohor, si dhe të mbështes reformën e politikave. Metodologjia e IQE është një koleksion i treguesve që mbështeten kryesisht në perceptimet e pronarëve të bizneseve që më pastaj janë standardizuar në një shkallë vlerësuese prej 10 pikësh dhe që përdoren për ndërtimin e nënindekseve përkatëse teorike (kategorive). Këto indekse janë përvijuar më pas në një indeks final të politikave relevante. Duke përdorur këtë

¹⁰ Shih Malesky (2008).

¹¹ Shih më tej planin e veprimit të Zyrës së Kryeministrit të QK për reformën ekonomike (në progres).

metodologji rigorozë të IQE si bazë, IKK është përshtatur me kujdes për të pasqyruar rrethanat unike në Kosovë

VLERËSIMI I QEVERISJES LOKALE NË KONTEKSTIN E KOSOVËS

Një numër i aspekteve të rëndësishme në Kosovë kërkon vëmendje këtu. Zhvillimi i IKK në Kosovë, në nivel komunal është shumë i ndryshëm nga vendet e tjera të studiuara më parë, së pari për shkak të madhësisë së tij krahasimisht të vogël, dhe së dyti për shkak të shifrave të konsiderueshme më të ulëta të popullsisë. Për shembull, Parteshi vlerësohet se ka rreth 5000-6000 banorë dhe vetëm një pjesë të vogël të bizneseve të regjistruara private. Madhësia e vogël të disa komunave ndikon në zgjedhjet e bëra në zhvillimin e strukturës së indeksit dhe në disa nga opsionet e treguesve dhe nën-indekseve.¹²

Në radhë të parë, në rastin kur përshtatet IKK në mjedisin lokal nuk do të kishte asnjë kuptim, për shembull, për të promovuar politika të caktuara për zhvillimin e sektorit privat që janë relevante në kontekst të IQE në një vend tjetër, të tilla si paniret komunale, objektet e arsimit të lartë, etj, të cilat janë rajonale apo edhe çështje në nivel kombëtar në një vend të tillë të vogël. Struktura e fundit e indeksit është projektuar për të pasqyruar këtë kontekst sa më shumë që është e mundur. Përveç kësaj, mjedisi rregullator që ndikon në biznes është kryesisht i administruar nga qendra, dhe për këtë arsye nuk mund të matet në nivel komunal.

MATJA DHE REZULTATI I KOMUNAVE TË REJA ME NUMËR TË VOGËL TË BIZNESEVE

Në një numër të komunave të reja, si dhe në komunat veriore serbe, ekziston një numër shumë i vogël i popullatës së regjistruar të biznesit, të cilat më tutje janë të kufizuara nga numri i ulët i bizneseve me numrat e telefonit dhe adresat e sakta. Me mostrat e vogla të bizneseve të anketës është e vështirë të paraqitet më shumë për mjedisin më të madh të biznesit.¹³ Ne duhet të marrim vendim të vështirë se si mund të jemi të sigurt sa i përket saktësisë dhe vlefshmërisë së rezultateve, por gjithashtu të ruajmë të gjitha komunat në vlerësim dhe në Indeks. Për të adresuar këtë çështje, për të tri komunat serbe të veriut, ne kemi vendosur që grupi i tyre së bashku si një. Në aspektin e mjedisit ekonomik dhe rregullator me të cilin ato përballen, ka të ngjarë të jenë shumë të ngjashme në secilën komunë dhe pasi që të tri komunat ka të ngjarë të kenë nivele të ngjashme të lidhjeve ekonomike dhe politike me Serbinë, rrethanat në të cilat operojnë bizneset janë unike brenda vetvetes.

Së dyti, komunat e reja të Parteshit dhe Ranillugut kanë popullsi të ngjashme të biznesit të vogël. Sipas të dhënave nga Administrata Tatimore, Parteshi dhe Ranillugu kanë në fakt secili vetëm katër biznese të regjistruara. Të dy komunat janë të formuara si komuna të reja vetëm në vitin e kaluar. Pasi që shumë nga pyetjet që iu janë bërë bizneseve ka të ngjarë të kenë përgjigje relevante për periudhën para formimit të këtyre komunave të reja, ne kemi vendosur të përfshijmë ato në komunën e tyre të mëparshme, të paktën për përsëritje të këtij viti të Indeksit, për të siguruar që

¹² Për popullsinë komunale të bizneseve dhe madhësinë e mostrës, , shih Shtojcën 5.

¹³ Në mënyrë të veçantë, mostrat e vogla e bëjnë të vështirë për të marrë rezultatet që janë statistkisht të rëndësishme, pa intervalet e besimit të gjerë.

ato janë marrë parasysh dhe zëri i bizneseve në këto komuna të reja është dëgjuar. Në përsëritjet e ardhshme, ky vendim do të rivlerësohet, përsëri duke u bazuar mbi popullatën e biznesit të regjistruar që ne mund ta anketojmë për t'u siguruar që mjedisi lokal i biznesit është i matur në mënyrë të drejtë dhe i raportuar.

Sa i përket strukturave paralele administrative dhe burimeve të shumta të fondeve komunale që ndodhin në shkallë të ndryshme në komunat me shumicë etnike serbe, pasi që kjo ndikon në mjedisin e biznesit, qoftë nëse kjo jep përfitime apo pengon biznesin, mund të shihet në një farë mase në rezultatet. Si komunë me shumicë etnike turke, Mamusha, gjithashtu merr ndihmë financiare dhe teknike nga Turqia që në mënyrë të ngjashme mund të ndikojë në mjedisin e biznesit.

DIZAJNI I INDEKSIT

Rezultatet e IKK janë krijuar përmes përgjigjeve të dhëna në pyetjet e anketës. Këto të dhëna janë grumbulluar dhe grupuar në tetë nën-indekse të gjera (kategori), të cilat individualisht secili është vlerësuar në një shkallë prej 1-10 pikë. Të kombinuar, këta tetë nën-indekse krijojnë një rezultat të përgjithshëm prej 80 pikësh të qeverisjes ekonomike për secilën komunë. Teknikisht, një komunë mund të arrijë një rezultat perfekt prej 80 pikësh në qoftë se vlerësohet më të gjitha notat e larta prej 10 pikësh në të gjitha tetë nën-indekset, megjithatë përsosshmëria është shumë e vështirë që të arrihet. Në të vërtetë, të gjitha komunat kanë rezultate shumë të ulëta në një apo më shumë nën-tregues.

Për të parë nëse indekset e tjera dhe qasjet e vlerësimit të qeverisjes ekonomike krahasojnë performancën në mes të vendeve të ndryshme, një aspekt kyç i rezultateve të IKK-së është totaliteti i pikëve bazohen në atë se si komunat kryejnë punët përkatëse në lidhje me njëra-tjetrin. Prandaj, rezultatet nuk janë të krahasueshme për disa masa ideale të qeverisjes, por ato duhet të shihen si masa të arritjeve krahasuese të komunave në kontekstin e Kosovës. Për një shpjegim të detajuar të strategjisë së rezultateve, shih Kapitullin 6 të këtij raporti. Tabela 1.1 paraqet nën-treguesit e IKK.

Tabela 1.1: Tetë nën-indeksat e IKK

1. Pengesat për nisjen e biznesit: Një masë e kohës që nevojitet për të marrë licencat e nevojshme dhe lejet për të filluar aktivitetet; një masë e konkurrencës me të cilën bizneset ndeshen në sektorin informal; dhe shkalla në të cilën lejet dhe regjistrimi përbëjnë një pengesë për formalizimin e biznesit

2. Parashikueshmëria dhe Pjesëmarrja: Një masë për të parë nëse bizneset konsultohen në lidhje me rregulloret e propozuara; nëse interesat e tyre janë të avancuara në politikat e reja; dhe shkalla në të cilën politikat e reja dhe ligjet janë komunikuar dhe zbatuar në mënyrë të parashikueshme.

3. Transparenca: Një masë për të parë nëse firmat kanë qasje në informatat e nevojshme për to në lidhje me rregullat dhe procedurat, si dhe buxhetin komunal dhe dokumentet e planifikimit, dhe nëse ky informacion është i disponueshëm për të gjithë.

4. Kostoja kohore e Pajtueshmërisë Rregullative: Një masë se sa kohë shpenzojnë firmat për pajtueshmërinë me rregullat dhe lehtësia e pajtueshmërisë; koha e kaluar në inspektimet e biznesit nga agjencitë komunale; dhe koha për të marrë lejen vjetore të punës

5. Taksat dhe tarifat: Një masë e shkallës dhe lehtësisë së pagesave të taksave; dhe një masë e negociatave joformale me rastin e pagesës së taksave.

6. Administrata komunale: Një masë e aftësive të zyrtarëve komunal dhe qëndrimet ndaj biznesit; një masë e kostos dhe shkallës në të cilën firmat duhet të bëjnë pagesa informale për zyrtarët komunal për shërbimet; si dhe një masë e barazisë në tenderimin komunal.

7. Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse të biznesit: Një masë e cilësisë së punëtorëve në dispozicion; një masë nëse fuqia punëtore lokale plotëson nevojat e biznesit; një masë e disponueshmërisë së shërbimeve këshilluese rregullatore; dhe a ka shërbime mbështetëse të biznesit në dispozicion

8. Infrastruktura komunale: Një masë e cilësisë së rrugëve dhe mirëmbajtjes së rrugëve, si dhe cilësisë së shërbimeve të ujit dhe kanalizimit.

STRATEGJIA E HULUMTIMIT

Indeksi i Konkurrencës në Komuna është bazuar në përgjigjet e një studimi në nivel të firmave të pronarëve të biznesit të Kosovës, të administruara në muajin mars 2011 në tërë vendin. Strategjia e hulumtimit është përbërë nga dy komponentë kryesorë: së pari, marrja e një kornize të mostrës së nivelit komunal nga e cila do të nxirret një mostër e shtresuar në mënyrë të rastësishme e bizneseve për anketë; së dyti, kryerja e intervistave ballë për ballë me pronarët e bizneseve në mostër për të marrë perceptimet e tyre dhe përvojat e të bërit biznes në komunën e tyre. Së fundi, gjetjet e anketës janë hartuar dhe analizuar për të përcaktuar treguesin final dhe përzgjedhjen e nën-indekseve.

Për të siguruar që rezultatet saktësisht reflektojnë kushtet në tërë vendin, anketa e sofistikuar dhe strategjitë e marrjes së mostrave janë shfrytëzuar për të siguruar që asnjë lloj i personit juridik ose të sektorit të biznesit ishte mbi apo nën përfaqësuar dhe se pyetjet e anketës kanë gjeneruar përgjigje kuptimplote. Në total, ishin anketuar 2.026 pronarët e bizneseve nga të gjitha komunat e Kosovës.

Për një përshkrim më të hollësishëm të mënyrës se si është dizajnuar dhe administruar, si dhe strategjinë e marrjes së mostrave, shih Kapitullin 6.

Tabela 1.2: Pasqyra e Dizajnit të IKK

Çka	Matja dhe krahasueshmëria e përvitshme e ambientit vendor për bizneset dhe politikat e veçanta të qeverisjes ekonomike, inicijativat dhe performancën e autoriteteve lokale Kornizë mostër e të gjitha bizneseve formale aktive në Kosovë Mostër e shtresuar rasti në nivel komunal, sipas sektorit dhe llojit të entitetit ligjor
Kush	IKK mostër e 2,026 pronarëve ose menaxherëve të biznesit Mostër mbështetëse për zëvendësim Mesatarisht 55 respondentë për komunë (me shkallë të përgjegjeve në 77%)
Si	Anketim sy-më-sy të pronarëve ose menaxherëve të biznesit
Ku	37 komuna në Mars 2011

PASQYRË E RAPORTIT 2011

Pjesa tjetër e raportit mbulon si në vijim:

- Kapitulli 2 i Raportit jep një portret të firmave të Kosovës.
- Kapitulli 3 paraqet rezultatet e IKK 2011 dhe gjetjet kryesore.
- Kapitulli 4 paraqet një diskutim intensiv të secilit prej nën-treguesve.
- Kapitulli 5 adreson vlerësimet e rëndësishme të politikave kombëtare duke përdorur të dhënat e IKK.
- Kapitulli 6 përshkruan metodologjinë, veçanërisht, strategjinë e marrjes së mostrave, procesin e dizajnit të protokollit të anketës dhe zbatimit, hapat e analizës së të dhënave, dhe ndërtimin e nën-indekseve dhe Indeksit.

2. PORTRETI I BIZNESEVE

Besueshmëria e IKK është krijuar jo vetëm në ndërtimin e indekseve, por edhe në mënyrën përmes së cilës firmat e anketuara janë zgjedhur. Indeksi 2011 i Konkurrencës në Komuna përfaqëson zërin kolektiv të ndërmarrjeve private vendore formale në Kosovë. Kjo pasqyrë e sektorit privat të Kosovës paraqet një portret të ndërmarrjes private në tërë vendin dhe një kontekst të plotë për të cilën janë dhënë përgjigje në anketë që është përdorur për të gjeneruar renditjen e vlerësimit 2011.

Një nga vendimet kryesore që është dashur të merret në fillim ishte nëse do të përfshihen apo jo bizneset joformale dhe bizneset formale në anketën e IKK. Sipas një raporti nga Agjencia Evropiane për Rindërtim në vitin 2007, ekonomia joformale në Kosovë është vlerësuar të jetë me vlerë rreth s të 605-793 milionë në vit, 27-35 % e PBB-së për periudhën 2004-2006. Kjo ekonomi e konsiderueshme informale vlerësohet se kryesisht përbëhet nga ndërmarrjet e vogla në fushën e ndërtimit dhe tregtisë.¹⁴ Përveç kësaj, një përqindje e konsiderueshme e biznesit është gjysmë e formalizuar (e definuar si biznes që nuk i kanë të gjitha regjistrimet e nevojshme, licencat dhe lejet, dhe që nuk i paguajnë të gjitha taksat). Prandaj, çdo vendim se kë duhet anketuar do të ketë pasoja të rëndësishme mbi natyrën e IKK. Qëllimi i IKK është përmirësimi i mjedisit afarist. Prandaj është vendosur që anketimi i bizneseve formale dhe gjysmë-formale më drejtpërdrejtë dhe më saktë do të identifikonte dhe maste peshën e vërtetë dhe kufizimet e performancës së biznesit dhe produktivitetit.¹⁵ Për më tepër, kompanitë informale nuk kanë përvojë të drejtpërdrejtë me rregullimet dhe prandaj mund të ofrojnë pasqyrë të jo të mjaftueshme.

Tabela 2.1: Pasqyrë e Bizneseve të Kosovës dhe Respondentëve të IKK¹⁶

	Popullsia Kombëtare	IKK Mostra e Bizneseve	IKK e Ponderuar
Bizneset në tërësi	42,309	2026	2026
Forma Ligjore			
Pronësi e Vetme	90%	93%	90%
Kompani me përgjegjësi të kufizuara	8%	5%	8%
Partneritete, Aksione të Përbashkëta & të Huaja	2%	2%	2%
Tërësisht	100%	100%	100%
Sektori Primar			
Shërbimet	33%	31%	33%
Tregëtia	49%	52%	52%
Përpunim & Ndërtimtari	16%	16%	14%
Bujqësi & Resurse natyrore	2%	1%	1%
Tërësisht	100%	100%	100%

* Bizneset e marra si mostër të IKK janë mostra e anketës së IKK, e shtresuar në nivel komunal

** IKK e ponderuar është mostra e anketës së ponderuar sipas pjesën së komunave të ndërmarrjeve për të krijuar një mostër përfaqësuese në nivel kombëtar


¹⁴ Për të kuptuar më mirë mjedisin e biznesit informal në Kosovë dhe pengesat të regjistrimit formal të biznesit, është kryer një anketë me një fokus grup joformal të biznesit dhe një fokus grup ekspertësh vendor

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Shifrat e popullatës në nivel kombëtar janë marrë nëpërmjet Administratës Tatimore të Kosovës dhe Agjencisë për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë. Shifrat e vlefshme që nga 01 dhjetori 2010, duke përfshi të gjitha bizneset aktive si me regjistrimin e biznesit dhe numrin fiskal. Popullata kombëtare përjashton të gjitha subjektet jo-private (që gjithsej janë 111).

Bazuar në një listë të bizneseve aktive të regjistruara në Administratën Tatimore dhe Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, 2.026 biznese janë zgjedhur rastësisht nga një nivel kombëtar prej 42,309 ndërmarrjeve private aktive. Janë ndërmarrë një numër masash kyçe sa i përket projektimit të marrjes së mostrave për të siguruar që kjo mostër është përfaqësuese e popullatës së biznesit të Kosovës. Për të marrë një mostër të besueshme përfaqësuese, respondentët e anketuar janë zgjedhur në bazë të sektorit të firmës së tyre dhe formës ligjore me anë të një strategjie të mostrave të të shtresuara të rastit në nivel komunal. Si rrjedhojë, firmat që janë përgjigjur anketës së IKK-së janë të krahasueshme me numrin e popullatës komunale dhe kombëtare të biznesit, siç është paraqitur në Tabelën 2.1.


Figura 2.1: Totali i Bizneseve aktive sipas subjektit ligjor



Një tipar kryesor i sektorit privat të Kosovës është dominimi i pronësisë personale, duke kontribuar në 90 % të popullsisë kombëtare, rreth mbi 38.000 ndërmarrje, ashtu siç është paraqitur në Tabelën 2.1 dhe Figurën 2.1.

Ky dominim i pronës personale është pasqyruar më për së afërmi në mostrën e IKK sipas madhësisë shumë të vogël të një numri të madh të firmave. Nga bizneset e marra si mostër, 81 % kanë më pak se katër të punësuar dhe 95 % kanë më pak se 10 të punësuar (Figura 2.2). Kjo shpërndarje reflekton popullatën e biznesit në Kosovë me përafërsisht 94 % të bizneseve me 1-4 të punësuar (në vitin 2008).¹⁷

Figure 2.2: Bizneset e IKK sipas numrit të të punësuarve



¹⁷ Shih Zyrën Statistikore të Kosovës (2008).

Për sa i përket shpërndarjes së biznesit sipas sektorëve, ashtu siç paraqitet në tabelën 2.1 më lartë, më pak se gjysma e sektorit privat në Kosovë është e angazhuar në sektorin e tregtisë. Më tej, pikërisht një e treta e të gjitha bizneseve private në Kosovë janë të angazhuara në shërbime. Ndërsa vetëm 1 % e sektorit të formalizuar privat operon në sektorët e bujqësisë dhe të burimeve natyrore, kjo pa dyshim në mënyrë të konsiderueshme nënvlerëson rolin e ekonomisë bujqësore në Kosovë, ku shumica e ndërmarrjeve të vogla bujqësore kanë mbetur në ekonominë informale. Në të vërtetë, siç u përmend më parë, një pjesë e konsiderueshme të pjesëve të varfra rurale të Kosovës mbeten të angazhuar kryesisht në nivelin e bujqësisë për mbijetesë.

Në aspektin e përfaqësimit gjinor në sektorin privat, Kosova ka një detyrë të madhe për të përmirësuar numrin jashtëzakonisht të ulët të bizneseve në pronësi nga gratë. Sipas të dhënave kombëtare, përqindja e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë ishte rreth 9 % në vitin 2008. Femrat pronare të bizneseve në mostrën e IKK janë përfaqësuar me 9 % të bizneseve (Tabela 2.2). Proporcioni në aspektin kombëtar të pjesëmarrjes në mes të femrave dhe meshkujve në fuqinë punëtore është 0,48, shumë më poshtë se mesatarja rajonale.¹⁸

Tabela 2.2: Pronarët e bizneseve sipas gjinisë

Pronarët e Bizneseve		
Gjinia	MCI Percentage	MCI Pristina
Meshkuj	91%	92.50%
Femra	9%	7.50%
Tërësisht	100%	100%

Në kryeqytet, në Prishtinë, ku ka më shumë mundësi për biznes, shifra për pronarët e bizneseve femra në të vërtetë ka rënë

më tej në rreth 7 %.¹⁹ Shpjegimi për këtë nuk është domosdoshmërisht se gratë janë më pak të pranishme në fuqinë punëtore në Prishtinë. Një arsye shumë bindëse për këtë rezultat është se shumë gra në Prishtinë janë të punësuar ose në kuadër të qeverisë kombëtare ose brenda komunitetit ndërkombëtar të donatorëve. Me një sërë punësh të tilla në dispozicion, më pak gra mund të jenë në kërkim që të kenë biznesin e tyre.

Së fundi, është ilustrative që të përmenden tregjet në të cilat firmat në mostrën e IIKK-së merren me biznes. Vetëm 4%, apo 86 firma nga një mostër prej 2026, janë firma që merren me eksport. Nga ato që merren me eksport, shumica dërrmuese janë firmat nga komunat serbe, si në veri po ashtu edhe në tërë pjesën tjetër të Kosovës. Kjo është ndoshta jo shumë e habitshme. Në veçanti, bizneset në komunat veriore shpesh nuk janë në gjendje të tregtojnë më poshtë lumit Ibër, pra me tregje të vogla në komunat e tyre, i vetmi treg tjetër është në veri në Serbi.²⁰

¹⁸ Shih Raportin e USAID të Vlerësimit të Performancës Ekonomike (2008).

¹⁹ Shih më tutje, http://pristina.usembassy.gov/conference_on_women_entrepreneurship.html dhe http://ee.unicef.org/kosovo/Getting_To_Lisbon_-_English.pdf

²⁰ Mungesa e qasjes në tregjet në jug të lumit Ibër për bizneset e serbëve të Kosovës në komunat veriore ishte një nga pengesat më të mëdha për rritjen e biznesit të identifikuar në intervistat me pronarët e bizneseve nga komunat serbe të veriut. Bazuar në intervistat e kryera nga autori në nëntor 2010.

Sektori privat në Kosovë është i dominuar nga meshkujt si pronarë të mikro pronës personale në mënyrë të qartë, të angazhuar në sektorin e tregtisë. Derisa sektori informal dhe shtrirja e sipërmarrjes është e padiskutueshme, mbizotërimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla është tregues i një baze të dobët dhe të ngushtë të industrializimit. Numri i ulët i bizneseve eksportuese mund të jetë tregues i një mjedisi të vështirë eksportues: Kosova aktualisht renditet e 132 në vlerësimet e BB-së për Bërjen e Biznesit dhe Tregtisë përtej *Kufijve*. Së fundi, mungesa e sipërmarrësve femra është shqetësuese për sa i përket jo vetëm progresit ekonomik, por edhe progresit shoqëror dhe mundësive në dispozicion për gratë.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme për të kuptuar jo vetëm atë që po e pengon rritjen e biznesit, por edhe atë se çfarë lehtëson biznesin në tërë Kosovën.

3. VLERËSIMI I IKK 2011: SHPJEGIM DHE ANALIZA

Së pari, renditja e komunave në IKKK ofron një mjet nëpërmjet të cilit politikëbërësit mund të marrin informata të rëndësishme për të cilat komuna dhe udhëheqësit në vend demonstrojnë praktikën më të mirë në fushën e qeverisjes dhe në ato fusha ku komunat e tjera ende duhet të bëjnë më shumë punë. Një krahasim i tillë kokë me kokë mund të ketë avantazhin e nxitjes së konkurrencës në mes të komunave, si dhe të ofrojë një dritare brenda Kosovës për klimën ekonomike të dhe të qeverisjes në vend.

Së dyti, për shkak të detyrës pothuajse të pamundur të përkthimit të çfarëdo vlerësimi në reforma të politikave, Raporti i IKK gjithashtu zëbërthehet në detaje të nën-indekseve specifike, duke identifikuar performuesit më mirë dhe treguesit e qeverisjes, dhe përkundrazi edhe tregon se ku është performanca e ulët. Kjo qasje e thuktë, duke paraqitur një numër të treguesve përkatës iu mundëson hartuesve të politikave të monitorojnë treguesit e pavarur të qeverisjes.

Së treti, për shkak të rezultateve shumë të ngushta të shumë komunave, të cilat qëndrojnë në pika dhjetore nga njëra-tjetri, renditja e komunave mund të jetë disi çorientuese.²¹ Në të vërtetë, mund të jetë punë e komplikuar që të mbledhen nën-indeksat në një mjet të dobishëm për politika. Për shembull, qeverisja e mirë në drejtim të transparencës ka më shumë gjasa që të ketë një ndikim më të madh në rezultatet e mjedisit të biznesit se shërbimet mbështetëse të biznesit. Prandaj, për të maksimizuar vlerën e IKK për hartuesit e politikave, duhet të kihet kujdes për të siguruar që vlerësimet e politikave përkatëse të nën-indekseve korrespondojnë me përmirësimet në qeverisjen ekonomike dhe performancën e sektorit privat. Vlerësimet individuale të nën-indekseve janë paraqitur në tabelën 3.1²²

Tabela 3.1: Vlerësimet e nën-indeksit

Nën-treguesi	T-Statistika	T-Statistika origjinale	Pjesët	Rëndësia e përafërt
Transparenca	2.58	Nuk vlen	19%	20%
Kostoja kohore e Përputhshmërisë	2.52	Nuk vlen	19%	20%
Administrata Komunale	2.17	Nuk vlen	16%	15%
Pjesëmarrja & Parashikueshmëria	1.66	Nuk vlen	12%	15%
Fuqia Punëtore & Shërbimet për Mbështetjen e Bizneseve	1.3	Nuk vlen	10%	10%
Infrastruktura Komunale	1.19	Nuk vlen	9%	10%
Tatimet & Tarifat	1	-0.63	7%	5%
Pengesat ndaj depërtimit të Bizneseve	1	-3.91	7%	5%

²¹ Çfarëdo gabimi në matje në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe gabimi në mostër në anketën në fjalë do të thotë se shumë renditje të komunave mund të jenë të padallueshëm nga njëri tjetri.

²² Vlerësimi i politikave relevante të nën-treguesve është arritur përmes një procedure prej tre hapash duke shfrytëzuar analizën e shumëllojshme të regresionit mbi probabilitetin e zgjerimit të biznesit gjatë dy viteve të ardhshme. Shih Kapitullin 6 për detajet e procesit të vlerësimit dhe Shtojcën 3 për rezultatet e regresionit të plotë. Ku t- statistika ishte negative (barriera për nisjen e biznesit/Tatimet & Tarifat) e përdorur për të rrethuar t-statistikën pozitive më të ulët (Infrastruktura).

Kjo pjesë paraqet rezultatet e IKK në tri mënyra të ndryshme, duke bërë të mundur identifikimin e objektivit të rezultateve dhe duke iu mundësuar politikëbërësve dhe lexuesve të shfrytëzojnë cilindo prej metodave të renditjes që iu përshtaten më së miri qëllimeve të tyre.²³ Në të vërtetë, për donatorët të cilët kërkojnë fushat ku do të fokusoheshin në aspektet shumë specifike të mjedisit të biznesit, ka pak kuptim që të bazojnë vendimet mbi rezultatet e grumbulluara. Kështu, qëllimi për të cilin rezultatet janë përdorur mund të ndihmojë në aplikimin e çdo qasjeje. Së pari, është paraqitur një pasqyrë e IKK-së finale me nën-indeksat e grumbulluara të vlerësuar për rëndësinë e politikave. Së dyti, IKK finale është paraqitur me nivelet e besimit në rezultatet komunale, dhe së treti, është prezantuar nën-indeksi i performancës dhe rezultateve të IKK-së në nivel komunal.


RENDITJA E PËRGJITHSHME

Renditjet e IKK 2011 janë paraqitur në figurën 3.1 më poshtë. Këto renditje përfaqësojnë pikët komunale të përmbledhura në të tetë nën-indeksat e vlerësuar (ponderuar). Në çdo nën-indeks një total prej 10 pikësh të mundshme përfaqëson një rezultat perfekt. Kështu, për të arritur një rezultat perfekt prej 80 pikësh, një komunë duhet të marrë 10 pikë, duke u vlerësuar me numër një në çdo tregues të çdo nën-indeksi. Pasi që IKK është një renditje e komunave krahasuar me njëra-tjetrën dhe jo për disa masa të jashtme, arritja e një rezultati perfekt është e mundur, edhe pse mjaft e vështirë dhe me pak gjasa. Në të vërtetë, në IKK 2011, renditja aktuale e rezultateve është nga Mamusha (57,26) deri te Peja (27,25).

Renditjet e IKK 2011 paraqesin një pamje interesante të mjedisit të biznesit në mbarë Kosovën. Në pozitën më të lartë, Mamusha, e vetmja komunë me shumicë turke, dhe komunë ekzistuese me të drejta të plota që nga viti 2008, qëndron si performuesi më i mirë në vendin e parë. Komunitat e renditura në vendin e dytë dhe tretë kanë 2 pikë më pak, me komunitat e Hanit të Elezit dhe Gjilanit me rezultatet pothuajse identike. Në anën tjetër të renditjes, Peja është e fundit me nën 30 pikë, dhe mbi 25 pikë më pak sesa Mamusha. Ky ndryshim thelbësor në pikë është i pazakontë, dhe sidomos në një vend relativisht të vogël. Renditjet e përgjithshme e Mamushës dhe Pejës kërkojnë vëmendje të ngushtë - për të identifikuar praktikën më të mirë në Mamushë dhe për të përcaktuar pse performanca e Pejës është aq e ulët.

²³ Për renditjen e jo të ponderuar të IKK, shih Shtojcën 2.

Figure 3.1: Renditja finale e IKK 2011 të ponderuar²⁴



Mamusha, Hani i Elezit dhe Juniku të gjitha janë ish pilot njësi komunale ish të themeluara në korrik 2005.²⁵ Në muajin gusht të vitit 2008, këto pilot njësi komunale janë shndërruar në komuna me të drejta të plota. Ndoshta më shumë se komunat e tjera, vëmendje e konsiderueshme ka qenë e përqendruar në qeverisjen institucionale dhe kapacitetin e këtyre komunave.²⁶ Kjo mund të llogaritet deri në një farë shkalle për performancën e lartë të Mamushës dhe Hanit të Elezit në IKK. Megjithatë, Juniku ka arritur rezultat disi më të ulët. Një shpjegim i mëtejshëm për performancën e shkëlqyer të Mamushës mund të jetë prania e financimit, lidhjet tregtare dhe projektet e ndërtimit të kapaciteteve nga Turqia.

²⁴ Renditjet e pa-ponderuara dhe të ponderuar të IKK janë të lidhura ngushtë. Shih Shtojcën 2 për marrëdhëniet.

²⁵ Pilot njësitë komunale për zbatimin e Rregullores 2000/45 e shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë

²⁶ Shih Komunikatën për Shtyp të Misionit të OSBE-së në Kosovë (mars 2010).

Ashtu siç tregon qartë renditja, shumë komuna janë brenda rrezes së ngushtë të rezultateve të njëri-tjetrit; me të vërtetë, shpesh ato dallojnë vetëm me pikë dhjetore. Për këtë arsye renditja aktuale e një komune më e mirë se e një komune tjetër është disi mashtruese dhe gjithashtu, jo reale. Çdo rezultat përfaqëson pikët mesatare të komunës të nxjerra nga treguesit e shumëfishtë në një anketë prej 2026 personave. Pasi që rezultat është nxjerrë nga një mostër prej rreth 77 individësh në çdo komunë, dhe jo nga regjistrim, natyrisht se kujdesi është i domosdoshëm në vlerësimin e rezultateve. Pasi që madhësia e mostrave nuk ishte shumë e madhe në të gjitha komunat, gabimet e marrjes së mostrave janë të pashmangshme, pavarësisht nga kujdesi në dizajnimin e mostrës.²⁷ Këto probleme janë endemike për sa i përket raporteve dhe hulumtimit të bazuar në anketë. Prandaj, renditjet e pastra të paraqitura në Figurën 3.1 disi e stër-zmadhon nivelin e saktësisë së rezultateve të IKK-së.

Dy qasjet e prezantimit janë zhvilluar për të adresuar këtë. Së pari, ngjyrat në Figurën 3.1 përvijojnë nivelet e performancës, ku komunat kanë performancë në mënyrë të konsiderueshme mbi nivelin tjetër më të ulët.²⁸ Ne mund të pohojmë me një shkallë të lartë të sigurisë që rezultatet përfaqësojnë rezultatin që më së shumti ka të ngjarë në kuadër të një rreze rezultatesh: në qoftë se anketa është bërë me marrjen e mostrave të përsëritura më se 100 herë, komunat do të vendosin brenda niveleve të njëjta të performancës 95% të kohës.

Së dyti, Figura 3.2 më poshtë qartë ilustron rangun e rezultateve të IKK që një komunë mund ta ketë me marrjen e mostrave të tilla të përsëritura, ku linjat rreth çdo rezultati të IKK përshkruajnë renditjen e rezultateve që ne mund të pohojmë me një shkallë të lartë të besueshmërisë.²⁹ Për fat të mirë, shumica e komunave bien brenda një game të ngushtë të rezultateve, dhe derisa ne nuk mund të rendisim në mënyrë të drejtë këto komuna mbi ose nën njëra-tjetrën, ata bëjnë pjesë në nivelet e performancës të paraqitura në Figurën 3.1. Megjithatë, janë disa komuna të cilat nga mostrat e përsëritura mund të marrin një gamë të gjerë rezultatesh të mundshme, e cila tregohet nga intervalet e gjera të besimit.³⁰ Në veçanti, Novobërda dallohet nga komunat e tjera me intervale të besimit të vërtetë të gjera. Një numër arsyes mund të shkaktojë intervale të mëdha të besimit. Së pari, kur përgjigjet në një komunë janë të shpërndara në tërë gamën e përgjigjeve të mundshme, kjo mund të shkaktojë intervale të mëdha të besimit. Së dyti, kur madhësia e mostrës është shumë e vogël, është shumë e vështirë të nxirren përfundime mbi të dhënat. Kjo është ajo që ka shumë mundësi që shkakton kryesisht variancën e madhe në Novobërdë, ku madhësia totale e mostrës ka qenë 25 biznese, dhe shkalla e përgjithshme e përgjigjeve të këtyre bizneseve për disa pyetje të anketës nganjëherë ishte nën 20. Një qasje mund të jetë heqja e Novobërdës nga renditja. Megjithatë, në vend se të penalizojmë komunën për numrin e vogël të bizneseve duke e hequr atë, ne kemi zgjedhur që të paraqesim intervalet e besimit, dhe ato duhet të shqyrtohen me kujdes

²⁷ Gabimi në marrjen e mostrës është një funksion i tre formave të variacionit 1) shpërndarja e përgjigjeve me një mostër për një çështje të caktuar, 2) numri i të anketuarve në një mostër, dhe 3) mundësinë e zgjedhjes së të anketuarit në një vend të veçantë.


²⁸ Nivelet janë përcaktuar nga identifikimi i atyre rezultateve që bien mbi çdo përqindje me një nivel prej 95 % të besimit: Grupimet janë nga përqindjet e larta 1) 90 për qind e më lart, 2) 75 përqindje e më lart, 3) 50 për qind e më lart, 4) 25 për qind e më lart, dhe 5) 1 për qind e më lart

²⁹ Vijat përshkruajnë 95 % të intervaleve të besimit rreth çdo rezultati të komunës

³⁰ Ibid.

para se të bazojmë çfarëdo vendimi të politikave mbi rezultatet në Novobërdë. E njëjta gjë duhet të vlej me rastin e shqyrtimit të rezultateve të nën-indekseve të cdo komune.³¹


Figura 3.2: Rendita e IKK 2011 të ponderuar me Intervalet e Besimit



Së fundi, në qasjen e tretë të shqyrtimit të rezultateve të IKK dhe renditjes, mund të shihen pikët në një nivel individual komunal. Yjet më poshtë paraqesin indeksin e ponderuar të nën-indeksit të IKK në çdo komunë. Një rezultat perfekt prej 80 pikësh do të jetë një rreth i përsosur ashtu siç e paraqet grafiku i fundit. Në anën tjetër, rezultati zero nuk do të tregojë asgjë. Rezultatet e ponderuara të IKK janë treguar për të ilustruar se ku komunat kanë performanca të mirë në aspektet të cilat luajnë një rol relativisht të madh në performancën e sektorit privat. Derisa Mamusha ka renditjen më të lartë, dobësia e saj thelbësor në pjesën e *Fuqisë Punëtore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Biznesit*, si dhe *Administratës Komunale*, spikaten shumë. Gjithashtu, Gjiilan është një komunë me performancë të lartë, por ka performanca të dobët veçanërisht në indekset e *Pjesëmarrjes dhe Parashikueshmërisë* si dhe *Transparencës*. Në të vërtetë, disa komuna kanë disa pjesë të vogla të prera nga performanca e qeverisjes ekonomike të tyre. Këto ilustrime të qarta të performancës së qeverisjes ekonomike nënvizojnë fushat e përparësive dhe dobësive relative në çdo lokalitet.

³¹ Shih Kapitullin 4 dhe Shtojcën 4 për detajet e rezultateve të nën-indeksit.

Figura 3.3: Rezultatet e ponderuara të nën-indeksit të IKK sipas komunave



Do të ishte e pakujdeshme nëse do të harronim ta përmendim pozitën e Prishtinës në renditje. Ajo nuk ka performanca as jashtëzakonisht të mirë e as të keqe. Duke rishikuar rezultateve të nën-indekseve individuale të komunës së kryeqytetit, ajo bënë pjesë goxha shumë në mesin e pothuajse të gjitha aspekteve të qeverisjes ekonomike të matur në IKK. Derisa ajo ka performancë relativisht të mirë në aspektin e *Kostos Kohore dhe Taksave dhe Tarifave*, ajo ka pozita goxha të ulët në aspektin e *Pengesat për Nisjen e Biznesit* dhe në pjesën e *Pjesëmarrjes dhe Parashikueshmërisë*.

Së fundi, është e qartë se komunat me shumicë serbe nuk qëndrojnë në fare mirë në renditje. Duhet theksuar se në komunat me shumicë serbe të Shtërpcës dhe Graçanicës, shumica e bizneseve të anketuara ishin biznese etnike serbe. Në Kllokot ky nuk ishte rasti. Nga 31 bizneset aktive të regjistruara, serbët etnikë zotërojnë më pak se gjysmën e këtyre. Ky numër i ulët i bizneseve në pronësi të serbëve etnik mund të jetë rezultat i strukturave paralele administrative në Kllokot dhe në këtë mënyrë edhe për shkak të integritimit të ulët të bizneseve etnike serbe të biznesit në strukturën rregullatore të Kosovës. Duhet të theksohet, megjithatë, se Kllokoti ka shënuar rezultatin më të ulët në Kosovë në aspektin e përqindjes së bizneseve të ballafaquara me konkurrencën nga sektori joformal: ky aspekt i mjedisit të biznesit të Kllokotit dhe, në veçanti, modelet ndër-etnike tregtare të tij, do të përfitojnë nga një analizë më e thellë.

Pyetjet e anketës nuk kanë bërë dallimin se me cilat struktura administrative publike kanë të bëjnë bizneset. Kështu që përgjigjet dhe renditjet në këto komuna besohet se tregojnë mjedisin e biznesit në të cilin firmat veprojnë pavarësisht nga strukturat paralele komunale administrative ose ndikimet nga Serbia.

Duke shkuar tutje në veri, tri komunat me shumicë serbe mbi lumin Ibër si grup gjithashtu janë paraqitur dobët në renditje. Megjithatë, Leposaviqi në mënyrë të konsiderueshme ka performancë të përgjithshme më të mirë se Zveçani dhe Zubin Potoku.

Tabela 3.2: Rezultatet e komunave veriore me serbe


Komuna	Rezultati IKK	95% CIs
Leposavic	39.48	36.85 - 42.10
Zvecan	34.03	31.94 - 36.12
Zubin Potok	36.04	33.58 - 38.50

Në Leposaviq (27 mostra të marra) mostra e rastësishme ka përfshirë vetëm bizneset serbe, dhe në Zveçan (13 mostra të marra) shumica ishin gjithashtu biznese serbe, por në Zubin Potok (23 mostra të marra) gjysma e bizneseve janë në pronësi të entiteteve të tjera (romët, shqiptarët, malazezët). Normat e përgjigjeve janë gjithashtu të larta në Leposaviq (84 %) dhe më e ulëta në Zveçan (74 %) dhe Zubin Potok (64 %). Kjo nuk është edhe aq e qartë nëse këto aspekte mund të kenë diçka në lidhje me variacionin e rezultateve.

NDIKIMI I QEVERISJËS SË MIRË

Duke përdorur IKK-në si një matje të qeverisjes ekonomike, Figura 3.4 ilustron ndikimin pozitiv të përmirësimeve në IKK me ndërmarrjet e reja për 1000 qytetarë. Ekziston një korrelacion i qartë pozitiv ndërmjet rezultateve të IKK dhe rezultateve të performancës së sektorit privat.³² Qeverisja e mirë ka një ndikim pozitiv në mjedisin e biznesit dhe në rezultatet e sektorit privat. Kjo thekson rëndësinë e përmirësimit të performancës së qeverisjes ekonomike në komuna në mbarë Kosovën.

Figura 3.4: Marrëdhënia në mes të Qeverisjes dhe Ndërmarrjeve të Reja për 1000 Qytetarë në Komuna



³² Shih Shtojcën 3 për tabelën e plotë të regresionit.

PËRFUNDIMET DHE IMPLIKIMET E POLITIKAVE

IKK jep informacione të vlefshme se si pronarët e bizneseve perceptojnë dhe kuptojnë mjedisin afarist (të biznesit) në të cilin ata veprojnë, me çfarë kufizime dhe ngarkesa përballen ato, si dhe perceptimet e tyre të performancës së sektorit publik në lidhje me treguesit e shumtë të qeverisjes ekonomike.

Duke theksuar variacionin në mes të komunave në të gjithë masat, IKK ofron një mjet të dobishëm të cilin mund ta shfrytëzojnë zyrtarët e nivelit lokal dhe qendror, sektori privat dhe komuniteti i donatorëve për të krahasuar punën e komunave dhe klimat ekonomike brenda vetë Kosovës.

Në esencë, shqyrtimi në nivel komunal dhe rajonal dhe analiza e rezultateve të IKK-së mund të ndihmojnë zyrtarët lokal dhe bizneset në zhvillimin e partneriteteve strategjike për të adresuar dobësitë dhe për t'u mbështetur në praktikën më të mira. Ajo gjithashtu siguron një mundësi për të identifikuar praktikën më të mira duke studiuar performancën dhe politikën në komunat që kanë shënuar performancë të mirë në disa nën-indekse ose tregues.

Si një mjet praktik për të udhëzuar hartuesit e politikave në planifikimin e reformave dhe në zhvillimin e një agjende për politika vepruese, indeksi mund të lehtësojë dialogun midis qeverisë së nivelit qendror dhe lokal.

Në vendet e mëparshme, ku është zbatuar një indeks i tillë, qeveritë lokale kanë përdorur Renditjet dhe Rezultatet e treguesve për të përcaktuar standarde për performancën e tyre dhe për të caktuar objektivat e indeksit zyrtar për vitin e ardhshëm, duke krijuar një qasje strategjike, transparente dhe të përgjegjshme për të përmirësuar mjedisin e tyre lokale të biznesit. Më tej, në nivelin qendror, qeverisë kanë përdorur indeksin për të ndihmuar në prioritizimin e politikë-bërjes së qeverisjes ekonomike mbarë kombëtare dhe agjendat e veprimit, si dhe për të plotësuar informacionin nga anketat e tjera në nivel kombëtar siç janë raportet Bankës Botërore të Bërjes së Biznesit dhe Anketave të Ndërmarrjeve.

Për të përfunduar, si një pikë nisjeje në formulimin e agjendave për veprim, zyrtarët komunal dhe qeveria kombëtare mund të dëshirojnë të përqendrohen në transparencën, ku gjetjet tregojnë korrelacionin më të madh me rezultatet e performancës së sektorit privat në aspektin e perspektivës për zgjerimin e biznesit, si dhe për krijimin e bizneseve të reja. Për të qenë të sigurt, reduktimi i pengesave dhe përmirësimi i pjesëmarrjes të të gjitha palëve në formësimin e politikave lokale dhe kombëtare duket se më tutje çon në përmirësime të ndjeshme.

4. REZULTATET E IKK SIPAS NËN-INDEKSIT

Ky kapitull paraqet në detaje nën-indeksit e IKK duke identifikuar komunitat me performancën më të lartë në çdo nën-indeks, si dhe informacionin që japin treguesit përbërës. Në këtë pikë është e rëndësishme që të mbani në mend që treguesit të përfshirë në IKK në mënyrë specifike synojnë aspektet në të cilat komunitat kanë aftësinë të ndikojnë. Shtojca 4 jep rezultatet përfundimtare për çdo komunë sipas nën-indeksit dhe treguesve individuale të komponentit.

1. PENGESAT PËR NISJEN E BIZNESEVE

Sipërmarrësit në Kosovë përballen me pengesa të mëdha për të hyrë në sektorin e biznesit formal. Në të vërtetë, raporti i Bankës Botërore i *Bërjes Biznes në Kosovë 2011* që rendit *Koston e Nisjes së Biznesit* në pozitën e 117 në aspektin global, tregon se koha dhe kostoja financiare e konsiderueshme kontribuojnë në shtrëngimet e nisjes së biznesit. Për bizneset informale, kostot e hyrjes në aspektin e kohës dhe procedurave për të filluar një biznes janë një nga pengesat kryesore për formalizimin e biznesit.³³ Qëllimi i këtij nën-indeksi është vlerësimi i variacionit në kostot e nisjes së biznesit dhe pengesat për firmat e reja në tërë komunitat. Ndërsa shumë komponentë të fillimit të biznesit janë të rregulluar në nivel qendror, ky nën-indeks fokusohet në iniciativat, politikat dhe rregulloret që shfaqen në nivel komunal.

Një iniciativë ka qenë themelimi i pikave ku ofrohen të gjitha shërbimet (One-Stop-Shop - OSS) në komuna. Që nga viti 2008, qeveria kombëtare është duke punuar në bashkëpunim me Bankën Botërore për zhvillimin e shërbimeve komunalet OSS për të lehtësuar regjistrimin e biznesit dhe përkrahje shtesë të biznesit.³⁴ Shkalla në të cilën OSS përmirëson koston e kohës për nisjen e biznesit mund të bëhet më e qartë gjatë dy viteve të ardhshme. Si një mjet krahasimit, IKK mund të sigurojë informacion të paçmueshëm në ndikimin e shërbimeve OSS në komuna.

Tani për tani, në një komunë me OSS, tre zyrtarët komunalë që punojnë në zyrën e OSS në kuadër të komunës u ankua se ka pasur aq pak reklamim dhe promovim të i shërbimeve të tyre që shumë pak sipërmarrës dinë që shërbimet e tyre ekzistojnë. Më tej, zyra e tyre ishte "fshehur" në cep të një kati të sipërm në ndërtesën e komunës. Ata vunë në dukje se kjo mungesë e kombinuar e pranisë së dukshme dhe të vetëdijes kishte prodhuar pak vlerë të shtuar për biznesin deri më tani në komunën e tyre.³⁵ Rezultatet e anketës së IKK sugjerojnë një tablo të ngjashme; nga komunitat pilot OSS në filli, vetëm një nga 70 bizneset e anketuara në Mitrovicë kanë identifikuar saktë një zyrë ekzistuese të OSS; tre nga 70 të anketuar në Gjakovë, gjashtë nga 60 në Dragash, dhe një nga 70 në Podujevë.³⁶ Angazhimi dhe proaktiviteti i udhëheqësve komunal për të përmirësuar ndërgjegjësimin e publikut

³³ Ashtu siç është identifikuar nëpërmjet një analize të studimit të rastit në sektorin informal, me një fokus grup me pjesëmarrësit e biznesit informal dhe një tjetër me ekspertë të ambientit ekonomik dhe të biznesit në Kosovë (shkurt 2011).

³⁴ Projekti i Bankës Botërore të Asistencës Teknike për Mjedisin e Biznesit (BETA)


³⁵ Intervistat e autorit me tre zyrtarë komunalë për OSS në një nga pilot komunitat fillestare të projektit të Bankës Botërore OSS, nëntor 2010

³⁶ Komunitat fillestare/pilot të OSS të Projektit BETA të Bankës Botërore kanë përfshirë: Mitrovicën, Dragashin, Istogun, Podujevën, Suharekën, Gjilanin, Gjakovën, Shtërpcën. OSS-të më tej janë zbatuar në të gjithë vendin dhe aktualisht janë duke u zbatuar pothuajse në të gjitha komunitat e mbetura.

dhe ofrimin e këtyre shërbimeve motivon përfshirjen specifike të kostos së kohës së regjistrimit të biznesit në këtë nën-indeks.³⁷

Në mesin e të anketuarve të IKK, viti mesatar dhe i mesëm i regjistrimit të biznesit ishte 2004. Ekziston një lidhje pozitive midis regjistrimit të biznesit në komunë dhe në ditët që nevojiten për të regjistruar atë, siç është paraqitur në Figurën 4.1 (ku 1 në boshtin x paraqet regjistrimin në një komunë).³⁸

Figura 4.1: Regjistrimi i biznesit në komunë dhe ditët e nevojshme për të regjistruar biznesin



Larg nga supozimi se regjistrimi i biznesit lokal do të zvogëlonte numrin e ditëve për të regjistruar biznesin, duket se kjo rrit kohën që duhet për të regjistruar një biznes. Kjo me gjasë është simptomatikë e mungesës së mëparshme të koordinimit ndërmjet administratave komunale dhe qendrore dhe në sistemet e menaxhimit internet të e- qeverisjes në internet. Përpjekjet në zbatim e sipër, jo vetëm që të zhvillojnë dhe përmirësojnë shërbimet lokale të OSS, por edhe për të avancuar sistemin kombëtar të e-qeverisjes, janë të mundshme për të përmirësuar ndjeshëm këtë situatë dhe zvogëlimin e kohës që nevojitet për të regjistruar biznesin, jo vetëm në komunë, por edhe në nivel kombëtar në kryeqytet, Prishtinë.


Ky nën-indeks është i përbërë nga dy dimensione, duke adresuar 1) kostot e kohës dhe numrin e dokumenteve të nevojshme për të filluar një biznes, dhe 2) ndikimin e sektorit informal në formalizimin e biznesit dhe barrën e marrjes së dokumenteve të nevojshme për të filluar një biznes. Rezultatet komunale nga ky nën-indeks janë

³⁷ Për një pamje kombëtare të kostove të nisjes së biznesit, shih Kapitullin 5

³⁸ Korrelacioni çift midis regjistrimit lokal dhe ditëve për të regjistruar është 0,13, me një nivel 95 % të besimit.


paraqitur në figurën 4.2 më poshtë.³⁹ Komunat me performancën e dukshme më të lartë në këtë nën-indeks janë: Lipjani (7,82), Kaçaniku (7,63) dhe Mamusha (7,45). Në fakt, shumica e pjesëve ekonomike në vend zënë janë në 15 pozitat më të larta, e cila nuk është parë në asnjërin prej nën-indekseve të tjera, dhe ato të gjitha janë të lidhura ngushtë së bashku. Këto rezultate të ngushta dhe intervalet e besimit rreth rezultateve janë paraqitur në Figurën 4.3. Përrjashtim për këtë është Gjilani (6,25).

Figura 4.2: Renditja e pengesave të nën-indeksit të nisjen e bizneseve



³⁹ Për detajet në llogaritjet dhe metodologjinë e përdorur për të ri-shkallëzuar treguesit mbi një shkallë nga 1-10 pikësh dhe për të krijuar nën-indeksin, shih Kapitullin 6

Figura 4.3: Pengesat e nën-indeksit të nisjes së bizneseve me 95% të Intervaleve të Besimit



Duke u kthyer në treguesit specifik, Dimensioni 1, *Koha dhe Dokumentet* është një masë e përbërë e barrës së kohës e përfshirë për një firmë për t'u regjistruar ligjërisht dhe numrin total të licencave dhe lejeve të nevojshme për të filluar operacionet.

Dimensioni 2, *Pengesat e Nisjes së Biznesit* përbëhen nga dy tregues të perceptimeve që adresojnë barrierat e nisjes së bizneseve të reja në komunë. Masa e parë identifikon shkallën në të cilën bizneset e përjetojnë konkurrencën nga sektori joformal.⁴⁰ Niveli i konkurrencës së pandershme nga sektori informal mund të konsiderohet një pengesë e madhe për nisjen e bizneseve: aty ku konkurrenca

⁴⁰ Për analiza të mëtejshme në sektorin informal, shih Bertelsmann Stiftung (2009).

joformale është e rëndësishme, bizneset kanë më pak gjasa për formalizohen ligjërisht dhe të përballen me kosto më të madhe sesa konkurrentët e tyre informal.⁴¹ Në të vërtetë, bizneset formale identifikojnë konkurrencën nga sektori joformal si një nga sfidat kryesore të biznesit të tyre.⁴² Derisa shumë përpjekje për të adresuar sektorin substancial joformal rrjedhin nga qeveria kombëtare, komunat kanë nxitje të forta për të nxitur formalizimin e biznesit në lokalitetet e tyre, të cilat jo vetëm që do të përmirësojnë dhe gjenerojnë hapësirë më të madhe për ato firma tashmë të formalizuara, por gjithashtu edhe do të sjellin të ardhura shtesë nëpërmjet taksave lokale. Masa e dytë është barra e perceptuar e regjistrimit të biznesit në përgjithësi dhe të procesit të lejeve për të filluar një biznes. Marrja e këtij informacioni hedh dritë mbi barrën me të cilat përballen bizneset që kanë ndërmarrë procesin dhe në shkallën në të cilën ky proces mund të meritojë vëmendje në një komunë të veçantë.

Tabela 4.1: Indikatorët që përfshijnë pengesat e nën-indeksit të Nisjes së Bizneseve

Indikatori	IKK Pyetja	Mesatarja kombëtare	KK Kombëtar e 95%	Rezultatet komunale	Rezultati	Komuna
Kohëzgjatja mesatare e ditëve për të regjistruar biznesin	B2	10.86	10.36-11.36	Min	5	Vushtrri
				Median	11	Gjilan
				Max	24	Mamushe
Numri mesatar i licencave dhe lejeve të nevojshme për të filluar aktivitetet	C1	2.73	2.67-2.80	Min	2	Novo Brdo
				Median	3	Junik
				Max	5	Obiliq
Përvoja e bizneseve me konkurrencën nga sektori joformal (% po)	A14	52%	49.67%-56.62%	Min	4%	Kllokot
				Median	54%	Skenderaj
				Max	98%	Shterpce
Procesi i regjistrimit të biznesit dhe marrjes së të gjitha lejeve të nevojshme si barriera për nisjen e biznesit (% po)	B5A	25%	21.72%-27.97%	Min	0%	Lipjan & Mamushe
				Median	20%	Suharekë
				Max	78%	Shterpce

* Kur ngjyrat ndajnë dy dimensione. ** C1 llogarit vetëm përgjigjet nga pronësia personale për shkak të lidhjes së rëndësishme në mes të llojeve të subjektit juridik dhe përgjigjeve të biznesit (për shpjegime të hollësishme për këtë, shih Kapitullin 6: Metodologjia).

⁴¹ Intervistat e autorit me pronarët e bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha në bizneset e përpunimit të ushqimit, ndërtimit, dhe eksport/importit, tetor 2010.

⁴² Ibid.

2. TRANSPARENCA

Ashtu si praktikantët e zhvillimit e po ashtu edhe akademikët konsiderojnë se mjedisi rregullator transparent është imperativ për qeverisje të mirë, si një nga faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin se sa është e favorshme klima lokale dhe kombëtare për performancën e sektorit privat.⁴³ Këtu transparenca është definuar si: rritje e fluksit të informacionit ekonomik, social dhe politik të besueshëm dhe në kohë të duhur në lidhje me ofrimin e shërbimeve qeveritare, si dhe politikat fiskale dhe monetare. Nga ana tjetër, mungesa e transparencës mund të konsiderohet kur informacioni është fshehur me qëllim ose është paraqitur ndryshe nga ai real, ose kur ka një dështim për të siguruar që informacioni i dhënë është relevant dhe i saktë.⁴⁴ Në Kosovë, si në shumë vende të tjera në zhvillim, informacioni bazë mbi ligjin dhe rregulloret që qeverisin bizneset shpesh është i paqartë, ose e vështirë për të ardhur deri te ai, dhe në Kosovë ku ndryshimet e nivelit qendror dhe lokal ligjor kanë ndodhur në një shkallë tepër të shpejtë, është e vështirë për bizneset të mbajnë hapin me këtë. Përmirësimi i qasjes në informata mund të jetë një nga qasjet më të lehta dhe më të shpejta për komunat për të përmirësuar mjedisin e biznesit të tyre pa kërkuar reforma apo investime të konsiderueshme. Reduktimi i dobësisë informative lejon bizneset të kenë qasje në informatat për të cilat ata kanë nevojë pa shpenzuar shumë kohë dhe me kosto potencialisht më të ulët financiare, dhe iu mundëson bizneseve për të ndërmarr investime plotësisht të informuara dhe vendime strategjike.

Për këtë qëllim, nën-indeksi mbi transparencën në mënyrë specifike adreson qasjen në informata dhe paanshmërinë e qasjes në informata përmes pesë treguesve të veçantë. Renditjet në figurën 4.4 më poshtë flasin për variacionin e gjerë në fushën e transparencës në tërë Kosovën. Mamusha qëndron si komuna me performancën më të lartë (7,89). Në mënyrë interesante, të tre komunat veriore serbe qëndrojnë më prapa (6,33), në një linjë me Prizrenin (6,33). Rezultati i lartë i të tri komunave veriore serbe këtu pa dyshim do të kërkojë vëmendje të mëtejshme. Në anën tjetër të medaljes është komuna e Graçanicës (1.84), me një renditje më të ulët se të gjitha komunat e tjera. Kjo renditje e ulët kërkon gjithashtu studim të mëtejshëm. Në të vërtetë, me peshë të rëndësishme dhe ndikim të transparencës në performancën e sektorit privat, nismat dhe politikat për të përmirësuar transparencën në Graçanicë ka shumë të ngjarë që të prodhojnë përmirësime të rëndësishme në mjedisin e biznesit.

Duke bërë një vështrim të përciptë në Figurën 4.5, intervalet e besimit rreth këtij nën-indeksi janë me të vërtetë të ngushta për shumicën e komunave. Kjo tregon një qëndrueshmëri shumë të fortë në perceptimet e firmave sa i përket transparencës në secilën komunë. Siç është vërejtur në Kapitullin 3, relevanca e politikave të transparencës mbi performancën ekonomike është shumë e rëndësishme.⁴⁵ Rezultatet konfirmojnë se ka mjaft vend për përmirësim. Përmirësimet në këtë fushë mund të bëhen pa investime të konsiderueshme në reforma të kushtueshme ose të vështira dhe mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në ecurinë e sektorit privat.

⁴³ Shih Kaufman, Daniel et al (2002).

⁴⁴ Shih Vishēanath, Tara, dhe Kaufmann, Daniel (1999).

⁴⁵ Shih gjithashtu Tabelën 3.1: Vlerësimi i nën-indeksit.

Figure 4.4: Renditja e nën-indeksiit të transparencës





Figure 4.5: Nën-indeksi i transparencës me 95% të Intervaleve të Besimit



Treguesit e transparencës janë të ndara në katër lloje të ndryshme të informacionit: 1) dokumentet e planifikimit dhe fiskale komunale, 2) politikat dhe rregulloret komunale, 3) informatat dhe formularët për licencat dhe lejet komunale, dhe 4) informatat për tenderët e ardhshëm publik komunal. Treguesi i fundit është një masë e barazisë - shkalla në të cilën lidhjet me zyrtarët komunal janë të nevojshme për qasje në informatat e lartpërmendura. Në nivel mbarëkombëtar, është me të vërtetë pozitive të theksohet se lidhjet e biznesit me zyrtarët komunal për qasje në informata të rëndësishme janë të nevojshme për vetëm 17% të kohës. Në nivel nën-kombëtar, Mamusha ishte komuna me performancën e qartë më të lartë në të gjitha vlerësimet që lidhen me qasjen në informata. Gjakova dhe Shtërpca janë dëshmuar si mjediset më të mira për barazi të qasjes në informata, me komunën e Lipjanit që gjendet në anën tjetër të spektrit, ku lidhjet me zyrtarët komunal për qasje në informata janë të domosdoshme për mesatarisht 60 % të kohës.

Tabela 4.2: Indikatorët që përfshijnë Nën-indeksin e Transparencës

Indikator	IKK Pyetja	Mesatarja Kombëtare	KK-të Kombëtare 95%	Rezultatet Komunale	Rezultatet	Komuna
Kategorizimi mesatar i qasjes në buxjetin komunal dhe në dokumentet planifikuese (1= e pamundur deri në 5= shumë e lehtë)	E1A, E1B, E1C	2.63	2.56-2.69	Min	1.10	Gracanica
				Mediani	2.58	Hani i Elezit & Lipjan
				Maks	3.94	Mamushe
Kategorizimi mesatar i qasjes në rregullore komunale dhe dokumente të politikave (1= e pamundur deri në 5= shumë e lehtë)	E1D, E1E, E1J, E1L	2.90	2.85-2.95	Min	1.53	Gracanica
				Mediani	2.90	Gjilan & Peja
				Maks	3.96	Mamushe
Kategorizimi mesatar i qasjes në informata dhe forma të licensimit dhe lejimit komunal (1= e pamundur deri në 5= shumë e lehtë)	E1G, E1H	2.98	2.922-3.04	Min	2.12	Shterpce
				Mediani	3.10	Podujeva
				Maks	4.00	Mamushe
Lidhshmëria me zyrtarët komunal për qasje në dokumentet e rëndësishme joformale të domosdoshme (% gjithmonë ose shpesh)	E2	17%	15%-19%	Min	0%	Gjakova & Shterpce
				Mediani	20%	Shtimja
				Maks	60%	Lipjan
Kategorizimi mesatar i qasjes në informata për tenderët komunal të rradhës (1= e pamundur deri në 5= shumë e lehtë)	E1K	2.60	2.53-2.68	Min	1.12	Kllokot
				Mediani	2.47	Decan
				Maks	3.93	Mamushe

3. PJESËMARRRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA


Të lidhura ngushtë me transparencën janë pjesëmarrja në ndryshimet rregullative në nivel nën-kombëtar dhe parashikueshmëria e ndryshimeve në udhëzimet administrative dhe në politika. Parashikueshmëria ka të bëjë me mënyrën përmes së cilës zbatohen rregulloret dhe udhëzimet komunale administrative. Të kuptuarit në nivel firme e vendimeve që merren është bërë imperativ për t'iu mundësuar bizneseve të planifikojnë për të ardhmen dhe të marrin vendime të informuara për investime.

Një masë e dytë e rëndësishme është shkalla në të cilën qytetarët janë të përfshirë në procesin planifikues dhe rregullator, duke mundësuar që të dëgjohet zëri i biznesit dhe të merret parasysh në legjislacionin lokal. Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe e biznesit në procesin rregullator luan një rol kyç në mbajtjen e qeverisë kombëtare dhe nën-kombëtare të përgjegjshme para qytetarëve. Në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i shoqatave të biznesit ekzistojnë në nivel komunal, si dhe grupe avokuese të biznesit në nivel kombëtar, duke përfshirë Odën Ekonomike të Kosovës, Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB) dhe Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. Me një numër të madh të organizatave ndërkombëtare dhe qeverive që këshillojnë

Kosovën në lidhje me politikat të cilat ndikojnë në sektorin privat, zëri i biznesit lokal nga grupet avokuese në nivel kombëtar dhe nën-kombëtar nuk është dëgjuar shpesh, me pjesëmarrje të kufizuar dhe marrëdhënie të dobëta me hisedarët kryesorë qendror dhe komunal që merren me hartimin e politikave.

Aty ku autoritetet sjellin sektorin privat në dialogun mbi politikat që ndikojnë në komunitetin e biznesit, reformat ka shumë të ngjarë që të përfshijnë ndryshime që janë të realizueshme dhe më efikase për të mundur rritjen ekonomike. Ashtu sic është paraqitur në Figurën 4.6 më poshtë, pjesëmarrja në procesin rregullator dhe parashikueshmëria janë të lidhura fuqishëm, por nivelet e tanishme janë seriozisht të ulëta.

Figure 4.6: Pjesëmarrja dhe Parashikueshmëria



Në renditjen e përgjithshme, Mamusha (8) renditet pothuajse për 5 pikë para komunave të tjera që janë në krye të renditjes. Me përfaqësim të njëjtat rezultate, pasojnë më larg Skenderaj (2,98), Gjilani (2,95), dhe Novobërda (2,91). Si rezultate më të larta në këtë indeks, këto rezultate janë tepër të dobëta. Relevanca politike e pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë në performancën ekonomike është e rëndësishme. Përmirësimet në këtë fushë janë të domosdoshme dhe mund të arrihen nëse "punohet pak më shumë" me anë të iniciativave lokale dhe jo përmes reformave të kushtueshme dhe të vështira.

Figura 4.7: Renditja e nën-indeksit të Pjesëmarrjes dhe Parashikueshmërisë




Figura 4.8: Nën-indeksi i Pjesëmarrjes dhe Parashikueshmërisë me 95% të Intervaleve të Besimit




Tabela 4.3: Treguesit që përfshijnë Nën-indeksin e Pjesëmarrjes dhe Parashikueshmërisë

Indikator	IKK Pyetja	Mesatarja Kombëtare	KK-të Kombëtare 95%	Rezultatet Komunale	Rezultati	Komuna
Kompanitë e paralajmëruara paraprakisht për ndryshimet ndaj/ ose për rregulloret e reja komunale dhe udhëzimet e reja administrative (% shpesh ose gjithmonë)	E5	7%	5%-9%	Min	0%	Gracanica, Lipjan & Podujeva
				Mediani	6%	Glogovc, Peja, Shterpce & Suharekë
				Maks	65%	Mamushe
Rregulloret e reja komunale dhe udhëzimet e reja administrative marrin parasysh interesat e firmave të avokuara në debatet publike dhe seancat dëgjimore publike (% shpesh ose gjithmonë)	E6	6.5%	5%-9%	Min	0%	Gracanica & Peja
				Mediani	9%	Mitrovica, Kacanik & Istog
				Maks	90%	Mamushe
Implementimi i rregulloreve komunale dhe udhëzimeve administrative është i parashikueshëm (% shpesh ose gjithmonë)	E7	18%	16%-20%	Min	0%	Shterpce
				Mediani	14%	Junik
				Maks	93%	Mamushe
Firmat njohtohen për debatet publike komunale mbi ndryshimet ndaj ose për politikatat, rregulloret ose rregullat e reja të komunës (% shpesh ose gjithmonë)	E3	4%	3%-5%	Min	0%	Gracanica, Junik, Peja & Podujeva
				Mediani	4%	Feizaj & Kllokot
				Maks	65%	Mamushe

4. KOSTOJA KOHORE E PAJTUESHMËRISË RREGULLATIVE

Bizneset iu nënshtrohen një numri të madh të inspektimeve në Kosovë nga departamentet e nivelit kombëtar, si dhe agjencitë e nivelit komunal. Një pjesë e konsiderueshme e sistemit të licencimit dhe lejeve është deleguar në nivelin komunal apo bënë pjesë në kompetencat e komunave, duke hapur rrugën për diskrecionin e nivelit komunal për të rregulluar përputhjen nëpërmjet inspektimeve. Një rishikim i përciptë paraqet një kuptim të llojeve të inspektimeve të cilat iu nënshtrohen bizneset në klimën aktuale të inspektimit: inspektimet për arkë fiskale, tatimi në pronë, lejet e punës, regjistrimi i biznesit, inspektimet e taksave, inspektimet e taksave komunale, departamenti i inspektimeve të punës, së bashku me inspektimet e nevojshme për shëndetin dhe sigurinë nga agjencitë e shumta. Përveç kësaj, firmat shpesh përballesh me më shumë se një inspektim në vit nga një agjenci e vetme.

Ky nën-tregues mbi Kostot Kohore dhe Pajtueshmërinë Rregullative bën matjen e barrës mbi bizneset për të ruajtur pajtueshmërinë me rregulloret lokale dhe kostoja oportune të kohës së shpenzuar nga menaxhmenti i lartë për të siguruar përputhjen, e cila redukton kohën në dispozicion për rritjen dhe drejtimin e një biznesi.

Në renditjen e përgjithshme, këtu Graçanica (7,40) shfaqet si komuna me performancën më të lartë. Ajo ndiqet ngushtë nga Prishtina (6,88), Shtërpca (6,77), dhe Juniku (6,60). Rezultatet në këtë nën-indeks janë veçanërisht interesante pasi që në renditjen e përgjithshme dhe në nën-indeks të tjera Prishtina dhe Graçanica kanë performancë mesatare, dhe në të vërtetë, në tërë nivelin Shtërpca ka rezultat goxha të dobët. Një shpjegim i mundshëm për koston e ulët kohore në Prishtinë mund të jetë që pronarët e bizneseve dhe menaxherët punësojnë asistencë të jashtme për të siguruar mbajtjen e pajtueshmërisë. Arsye të qëndrojnë pas këtyre treguesve të ulët të koston kohore kërkojnë hulumtime të mëtejshme.

Figure 4.9: Renditja e nën-indeksit të koston së kohës për pajtueshmërinë rregullative





Figure 4.10: Nën-indeksi i kostos së kohës me 95% të Intervaleve të Besimit



Nën-indeksi i kostos së kohës përbëhet nga katër tregues që përfshijnë ata fajtorë që konsiderohen si faktorët më substancial të cilët kanë të ngjarë të ndikojnë në kohën e firmave të shpenzuar kaluar në pajtueshmërinë rregullative. Të gjithë faktorët ndodhin në baza vjetore dhe kur kombinohen, mund të zvogëlojnë ndjeshëm kohën që drejtuesit e lartë mund të kalojnë në çështjet substanciale të biznesit. Ndërsa tre treguesit e parë merren me *inspektimet në mënyrë specifike nga agjencitë e nivelit komunal* dhe më numrin e ditëve të nevojshme për të mbajtur pajtueshmërinë, treguesi i katërt ka të bëjë me lehtësinë e pajtueshmërisë, i matur me numrin e zyrave të veçanta komunale që duhet të vizitohen për të mbajtur pajtueshmërinë me rregulloret lokale.

Tabela 4.4: Treguesit që përfshijnë nën-indeksin e kostos kohore

Indikatori	IKK Pyetja	Kombëtar ja Mesatare	KK-të kombëtare 95%	Rezultatet Komunale	Rezult ati	Komuna
Numri mesatar i ditëve të menagjimit sipëror të shpenzuara në kontakt me zyrtarë komunal për të siguruar përputhshmëri me rregulloret	F1	6.50	6.14-6.85	Min	1	Pristina
				Mediani	6	Glllogovc
				Maks	19	Gjilan
Numri mesatar i herëve kur biznesi i nënshtrohet inspektimit të agjencive komunale	F2	2	2.03-2.30	Min	0.5	L-ZP-Zvecan
				Mediani	2.5	Gjilan
				Maks	5	Dragash
Numri mesatar i ditëve që kërkohen për të marrë lejen vjetore të punës	C2B	10	10.15-11.31	Min	4	Mamushe
				Mediani	10.5	Gjilan
				Maks	22	L-ZP-Zvecan
Numri mesatar i zyrave të veçanta komunale të vizituara për të ruajtur përputhshmërinë me rregulloret lokale	J3	2	1.82-1.99	Min	0	Suharekë
				Mediani	2	Rahovek
				Maks	4	Kllokot

* Aty ku F1 dhe J3 përdorin rezultatet vetëm nga pronësia personale për shkak të korrelacionit të rezultateve me llojin e subjektit juridik. Pyetja F1 i përgjigjet 2 komunave që janë nën 20 pikë duke e bërë këtë (Peja 17), (Novobërda 17), megjithatë, intervalet e besimit për këto rezultatet e përgjithshme të nën-indeksit të këtyre komunave ofrojnë një renditje në të cilin rezultatet e tyre të fundit duhet të merren parasysh. Novobërda ka rënë gjithashtu edhe për J3 (19).

5. TAKSAT DHE TARIFAT: KOSTOT ME TË CILAT PËRBALLEN BIZNESET

Për të rritur të hyrat e tyre vetanake, komunat kanë të drejtë të nxjerrin udhëzime administrative për të vjelë taksa dhe tarifa. Çdo komunë e ka grupin e vet të qëllimeve të të hyrave vetanake dhe aplikon një metodë të ndryshme të mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat e tjera. Çfarëdo të hyra të mbledhura ose të pranuar nga komuna nga burimet e mëposhtme paraqet të hyrat vetanake:

Tabela 4.5: Të hyrat vetanake të komunës


Taksat, Rentat, Gjobat, Bashkë pagesat	Taksat dhe pagesat komunale
Taksa e Zhvillimit të infrastrukturës	Taksa në Pronën e Paluajtshme
Gjobat në trafik	Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste
Gjobat për Shkeljen e Rregulloreve Komunale	Taksa për Lejen për Shërbime Profesionale
Të hyrat nga qiradhënia	Taksat Administrative Komunale
Bashkë pagesat për Arsim dhe Shëndetësi	Taksat për Lejet për Ndërtimin dhe Rrënimin e Ndërtesave
Të hyrat e tjera vetanake ⁴⁶	Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare
	Taksat tjera Komunale ⁴⁷

⁴⁶ Asociacioni i Komunave të Kosovës, Doracaku i Qeverisjes Lokale (Prishtinë, 2009).

⁴⁷ Ibid.

Kjo politikë ka hapur edhe rrugën për 'shfaqjen e problemeve' me tarifa dhe korrupsionit. Korrupsioni këtu lind nga shfrytëzimi i marrëdhënie të ngushta dhe mbledhja e dobët e të hyrave tatimore nga miqtë dhe anëtarët e familjes.⁴⁸ Në të vërtetë, taksat nuk mblihen në mënyrë të vazhdueshme, një rezultat i mundshëm i metodave jokonsistente dhe të pa standardizuara për mbledhjen e taksave dhe nivelit të lartë të korrupsionit.⁴⁹ Nga perspektiva e biznesit, nuk është befasues e që udhëheqësit e shoqatave të bizneseve dhe pronarët e bizneseve bëjnë thirrje për ulje të konsiderueshme të taksave mbi biznesin.⁵⁰ Kjo pjesërisht shfaqet prej frustrimi nga pagesa e taksave komunale me qeverisjen dhe alokimet buxhetore të dobëta, dhe ku përmirësimet përkatëse të dukshme për transport, infrastrukturë dhe shërbime të tjera publike komunale mbeten ende të paqarta.⁵¹ Në fakt aty ku korrupsioni përmes negociatave informale me zyrtarët e taksave është më i ulët, bizneset ka shumë të ngjarë që t'i konsiderojnë taksat më pak si pengesa për biznesin, sic është paraqitur më poshtë në Figurën 4.11.⁵²

Figure 4.11: Korrelacioni në mes të negociatave informale për Taksa dhe Taksave si pengesë për Biznesin



⁴⁸ Shih Blair, Melinda (2007).

⁴⁹ Ibid.

⁵⁰ Intervista e autorit me udhëheqësit e shoqatave të biznesit dhe pronarët e bizneseve në Prizren dhe Mitrovicë, përkatësisht, tetor 2010.

⁵¹ Intervista e autorit me pronarët e bizneseve në Mitrovicë, tetor 2010.

⁵² Në mënyrë të veçantë, këta dy tregues (kufizimet për biznesin dhe negociatat joformale me zyrtarët e taksave) kanë një korrelacion çift me 0,19, me një nivel prej 95 % të besimit

Ekziston dëshmi e fortë për të sugjeruar që përmirësimet në mjedisin e biznesit në nivelin komunal mund të realizohen duke zvogëluar pengesat e informacionit mbi të hyrat dhe shpenzimet komunalem si dhe riorganizimi dhe përmirësimi i transparencës dhe barazisë së tatimeve dhe taksave në nivel komunal.

Duke iu kthyer edhe një herë rezultateve, Mamusha (8,74) renditet lartë, duke udhëhequr renditjen e nën-indeksit. Shumë afër me të njëjtin rezultat janë Klllokoti (8.2) dhe Shtërpca (8.2). Performancë të ulët kanë Istogu (5), Vushtrria (4.8), Rahoveci (5.19), dhe Juniku (5.25). Më tej, ashtu sic ilustron qartë Figura 4.13, ekziston një prerje e qartë statistikore e rëndësishme në mes të komunave me performanca të ulët dhe rezultateve të ardhshme.

Figura 4.12: Renditja e Nën-indeksit të Taksave dhe Tarifave





Figura 4.13: Nën-indeksi i Taksave dhe Tarifave me 95% të Intervaleve të Besimit



Rishikimi i treguesve që përfshijnë nën-indeksin e *Taksave dhe Tarifave*, është bërë përpjekje për t'u fokusuar sa më shumë në faktorët që komunat mund t'i adresojnë për të përmirësuar renditjen e tyre dhe cilësinë e klimës lokale të biznesit të tyre. Treguesi i parë mat barrën administrative tatimore mbi bizneset, ku një maksimum prej pesë pagesave tatimore në vit është në përputhje me rregulloret. Treguesi i dytë mat shkallën në të cilën grumbullimi i taksave është i barabartë dhe nuk ka korrupsion, duke përfshirë shkallën në të cilën shumica e taksave të detyruara mund të negociohet jo zyrtarisht me zyrtarët tatimorë. Treguesi i tretë mat shkallën në të cilën taksat janë konsideruar si një pengesë për biznesin. Derisa mund të pritët një shifër e lartë, me mesataren kombëtare në 73%, është interesante të nënvizohet ndryshimi thelbësor në perceptimin e biznesit për këtë tregues në të gjitha komunat. Ashtu sic tregon Figura 4.11, përmirësime në treguesin e negociatave joformale të taksave ka të ngjarë të shtyjë bizneset të mendojnë se taksat janë më pak shtrëngesë për biznesin e tyre. Treguesi i katërt mat shkallën në të cilën janë paguar taksat, e cila gjithashtu ka gjasa të jetë disi e mbivlerësuar, pasi që firmat ka shumë të ngjarë që në anketë të stërzmadhojnë faktin se ato i paguajnë taksat apo jo. Në të vërtetë, të dhënat nga Prizreni tregojnë se ky është pikërisht rasti, ku grumbullimi i taksave llogaritet në rreth 60% në vitin 2010, krahasuar me 90% që është raportuar vetë nga bizneset e Prizrenit në anketë.⁵³ Treguesi i fundit jep një masë të shkallës në të cilën bizneset iu nënshtrohen taksave dhe tarifave të ndryshme komunale. Pasi që këto taksa dhe tarifa janë thjeshtë objekt i diskrecionit të komunës, pritët të ketë një variacion të konsiderueshëm në mesataret komunale, nga një mesatare minimale prej 0% në Viti deri në një maksimum prej 98 % mesatarisht në Dragash.

⁵³ Niveli i mbledhjes së tatimit në Prizren bazuar në intervistat e autorit me Drejtorin e Prizrenit për Ekonomi dhe Financa, tetor 2010..

Tabela 4.6: Treguesit që përfshijnë Nën-indeksin e Taksave dhe Tarifave

Indikatori	IKK Pyetja	National Average	KK-të Kombëtare 95%	Rezultatet Komunale	Rezultati	Komuna
Bizneset bëjnë mbi 5 pagesa tatimore në vjet (% po)	G2A2	9%	7%-11%	Min	0%	<i>Të numërt</i>
				Mediani	4%	Kamenica, Mitrovica, Podujeva,
				Maks	68%	Istog
Negocijatat jo-formale me zyrtarët komunal janë normale (% pajtohem dhe pajtohem fuqimisht)	G5	41%	38%-44%	Min	4%	Suharekë
				Mediani	38%	Decan & Hani I Elezit
				Maks	91%	Vushtri
Tatimet janë ngarkesë e madhe për bizneset (% e firmave që pajtohen fuqimisht ose që pajtohen)	G3	73%	71%-76%	Min	16%	Kllokot
				Mediani	70%	Decan, Novo Brdo, Shtimja
				Maks	99%	Rahovec
Kompanitë që paguajnë tatimet (% po)	G2A1	92%	90%-93%	Min	36%	Gjakova
				Mediani	94%	Fushe Kosova & Kacanik
				Maks	100%	<i>Numerous</i>
Bizneset që paguajnë tarifat komunale profesionale për biznes ose tatime dhe tarifa të tjera komunale (% po)	G2D1, G2F1	34%	32%-37%	Min	0%	Kllokot
				Mediani	47%	Malisheva & Shtimja
				Maks	97%	Dragash

* Për treguesin e fundit (G2D1, G2F1) dhe G2A1 vetëm përgjigjet nga pronësia personale janë përdorur për shkak të korrelacionit të tipit të firmës me pyetjet

6. ADMINISTRATA KOMUNALE

Administrimi i institucioneve të qeverisjes lokale edhe është i vështirësuar për shkak të aftësive dhe kapacitetit të dobët. Dëbimi i nëpunësve civil dhe profesionistëve shqiptar në Kosovë gjatë viteve 1990, i ndjekur nga lufta në vitet 1998-1999, la një mungesë të madhe të aftësive dhe punëtorëve të kualifikuar për shërbimin publik. Komunat vuajnë shumë nga kapaciteti i dobët pjesërisht për shkak të kësaj. Duke qenë të kombinuar me kapacitetet e dobëta strukturore në sistemin e administratës publike, këta faktorë mbeten pengesa thelbësore për punën efektive.⁵⁴

Në renditjen e përgjithshme të këtij nën-indeksi, Mamusha (9,19) përsëri është për 2 pikë më lartë se komuna pasuese me rezultat të lartë, Gjakova (7,04), e ndjekur nga afër nga Gjilani (6,81). Në pozitën e fundit, Peja (2,81) gjendet shumë më poshtë se komuna tjetër më rezultatin e ulët, Kllokoti (4,06) që ka shënuar pak më shumë se 1

⁵⁴ Shih Bertelsmann Stiftung (2009).

pikë më të shumë se Peja. Nuk ka asnjë dëshmi për korrelacionin në mes të komunave që kanë shënuar rezultate të larta dhe komunave të vjetra, duke sugjeruar se performanca e dobët dhe kapacitetet administrative janë endemike në tërë vendin. Në të vërtetë, komuna e re e Mamushës përsëri është shumë lartë në krye. Prishtinë (4,53) zë veçanërisht një pozitë të ulët në këtë nën-indeks.

Figura 4.14: Renditja e nën-indeksit të Administratës Komunale




Figura 4.15: Nën-indeksi i Administratës Komunale më 95% të Intervaleve të Besimit




Tabela 4.7: Treguesit që përfshijnë nën-indeksin e administratës komunale

Indikatori	IKK Pyetja	Mesatarja Kombëtare	KK-të kombëtare 95%	Rezultat Komunal	Rezultati	Komuna
Qëndrimi i zyrtarëve komunal ndaj bizneseve private (% pozitiv ose fuqishëm pozitiv)	J2	39%	36.5%-42%	Min	2%	Shterpece
				Mediani	43%	Dragash
				Maks	87.50%	Mamushe
Aftësia e përgjithshme e zyrtarëve dhe zyrtarëve administrativ në komunë (% shumë ndihmuese ose esenciale)	J4	16%	14%-18.5%	Min	1%	Peja
				Mediani	18%	Malisheva
				Maks	80%	Mamushe
Kompanitë zakonisht paguajnë mbi 5% të të hyrave në pagesa jo-zyrtare për zyrtarët komunal (% po)	K2	10%	8%-12%	Min	0%	Numerous
				Mediani	4.30%	Podujeva
				Maks	65%	Rahovec
Vlera e pagesave jo-formale për zyrtarët komunal në marrjen e një shërbimi komunal (% shumë ndihmues ose esencial)	K4	27%	24%-30.5%	Min	0%	Dragash & Mamushe
				Mediani	20%	Novo Brdo & Vitia
				Maks	96%	Kllokot
Lidhjet e rëndësishme për të fituar tenderët komunal publik (% pajtohem ose fuqimisht pajtohem)	K6	59%	56%-63%	Min	5%	Mamushe
				Mediani	56%	Kacanik
				Maks	84%	Peja & Kllokot

* Dimensioni 1 dhe 2 janë treguar me ngjyra të ndryshme. Pyetja K2 - vetëm përgjigjet e vetme të pronësisë personale të përfshira për shkak se K2 është i lidhur me subjektet juridike.

7. FUQIA PUNËTORE DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE TË BIZNESIT

Gjysma e popullsisë në moshë të punës në Kosovë nuk ka përfunduar arsimin e mesëm, dhe vetëm një numër syresh ka të kryer arsimin e lartë.⁵⁵ Pasi që kërkesa për aftësi të larta por rritet, firmat do ta kenë gjithnjë e më vështirë për të rekrutuar fuqi punëtor me aftësitë e nevojshme. Në fakt, firmat tashmë përballen me vështirësi në gjetjen e punëtorëve me aftësi të përshtatshme dhe të trajnuar mirë. Kjo ka të ngjarë që të rritet vetëm pasi që kërkesa për aftësi të larta është duke u rritur dhe sektorit privat në rritje e sipër kërkon fuqi punëtoresh të kualifikuar. Përmirësimi i qasjes në arsim dhe investimet në institucionet arsimore tashmë janë një domosdoshmëri, por ekziston një nevojë e menjëhershme dhe mundësi për të përmirësuar aftësitë e fuqisë punëtoresh nëpërmjet formimit profesional dhe programeve të punës. Cilësia e institucioneve të arsimit të lartë dhe niveli i të arriturave arsimore nuk përfshirë në IKK për dy arsye. Së pari, investimet në institucionet arsimore dhe përmirësimet në

⁵⁵ Shih Memorandumin Ekonomik të Bankës Botërore (2010)

arritjet arsimore janë angazhime afatmesme dhe afatgjata. Çdo përmirësim nuk ka të ngjarë që të reflektohet në përsëritjet vjetore të anketës së IKK-së. Së dyti, institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë të shpërndara në nivel rajonal. Kështu, është e pamundur, dhe kjo do të jetë gjithashtu e pamatur dhe e padrejtë, për të vlerësuar të gjitha komunat sipas një treguesi të tillë.

Në vend të kësaj, dimensionin e fuqisë punëtore të këtij nën-indeksi fokusohet mbi cilësinë dhe disponueshmërinë e fuqisë punëtore lokale të kualifikuar, ku qasja në programet e formimit profesional mund të përmirësojë aftësitë dhe cilësinë e fuqisë punëtore të kërkuar nga biznesi lokal në afat të shkurtër.

Sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, komunat janë përgjegjëse për shumë aspekte të qeverisjes lokale ekonomike.⁵⁶ Komunat kanë përgjegjësinë për krijimin e kushteve për një klimë konkurruese ekonomike në lokalitetet e tyre. Autonomia komunale ekziston për të rritur bashkëpunimin me organizata që punojnë në përmirësimin e mjedisit të biznesit, të tilla si odat e tregtisë, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, si dhe për të mundësuar ofrimin nga komunat të ndihmës së drejtpërdrejtë teknike nëpërmjet qendrave të biznesit, si dhe trajnimin dhe informimin për qytetarët të cilët krijojnë biznese të reja.⁵⁷ Për shkak të madhësisë së vogël të komunave të caktuara, ky nën-indeksi fokusohet në shërbimet mbështetëse të biznesit që kanë kuptim në nivel lokal në të gjitha komunat.⁵⁸

Në renditjen e përgjithshme të *Fuqisë Punëtore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Biznesit*, Istogu (8,40) zë vendin e parë si komuna me performancën më të lartë. Podujeva (7,65) gjithashtu është vendosur goxha mirë në vendin e dytë, me Hanin e Elezit (6,90) dhe Gjilanin (6,70), në pozitat tre dhe katër. Pak më shumë se 1 pikë, Shtërpca (1,45) është e fundit, duke shënuar rezultatin më të ulët në mënyrë të konsiderueshme sesa Vushtrria (2,51).

⁵⁶ Shih UNMIK (2007).

⁵⁷ Shih Asociacionin e Komunave të Kosovës (2009) dhe ligjin kombëtar specifik, shih UNMIK (2005).

⁵⁸ Për diskutim në lidhje me këtë, shih Kapitullin 1.

Figure 4.16: Renditja e nën-indeksit të fuqisë punëtore dhe shërbimeve mbështetëse të biznesit





Figure 4.17: Nën-indeksi i fuqisë punëtore dhe shërbimeve mbështetëse të biznesit me 95% të intervaleve të besimit



Siç u përmend, nën-indeksi është ndarë në dy dimensione, njëri përbëhet nga aspektet që lidhen me cilësinë e fuqisë punëtore lokale, dhe dimensionin tjetër në lidhje me shërbimet mbështetëse të biznesit në nivelin lokal në dispozicion. Dimensionin 1 në lidhje me fuqinë punëtore lokale mat aspektet e fuqisë punëtore lokale të cilat mund të ndikohen nga investimet komunale në politikën dhe iniciativat të cilat janë logjike në nivelin komunal të qeverisjes. Në treguesin e parë të Dimensionit 1, Gjakova renditet në krye me 98,50 %. Reputacioni i Gjakovës në tërë Kosovën si një qendër e veprimtarisë historike intelektuale dhe me kapacitete mund të dëshmojë në këtë rezultat të lartë.

Treguesit brenda Dimensionit 2 mat disponueshmërinë e shërbimeve të dobishme për biznesin lokal. Në mënyrë të veçantë, treguesi i parë mat disponueshmërinë e shërbimeve këshilluese rregullative, që cilësohen si të vlefshme për bizneset në aspektin e ritmit të shpejtë të reformës rregullatore në Kosovë në të dy nivelet komunale dhe kombëtare. Treguesi i dytë mat disponueshmërinë e një sërë shërbimesh mbështetëse të biznesit duke përfshirë ndihmën në promovimin e eksportit dhe informacionin, shërbimet për promovimin e biznesit lokal, si dhe shërbimet e rekrutimit dhe të punësimit. Komunitat nuk janë renditur nëse ato ofrojnë shërbime apo nëse shërbimet ofrohen nga një subjekt privat. Në të vërtetë, aty ku subjektet private ose qeveritare kombëtare ofrojnë këto shërbime në komuna, nuk ka arsye për komunitat për të duplikuar këtë punë; në vend të kësaj komunitat mund

të inkurajojnë dhe promovojnë disponueshmërinë e këtyre shërbimeve. Në të dy treguesit e Dimensionit 2, Graçanica renditet në fund së bashku me një pjesë të vogël të komunave të tjera. Çuditërisht, në fushën e disponueshmërisë së shërbimeve mbështetëse të biznesit, rezultati mesatar i Prishtina renditet vetëm në nivelin mesatare prej 14%. Ky konstatim është befasisht i ulët, dhe kërkon studim të mëtejshëm, duke qenë se Prishtina është një qendër e aktivitetit të biznesit në Kosovë, me numrin e madh të organizatave të vendosura në qytet.

Tabela 4.8: Treguesit që përfshijnë nën-indeksin e shërbimeve mbështetëse të biznesit dhe fuqisë punëtore

Indikatori	IKK Pyetja	Mesatarj a Kombëta re	KK-të Kombëtar e 95%	Rezultatet Komunale	Rezult ati	Komuna
Cilësia e arsimimit të përgjithshëm & niveli i trajnimit profesional të punëtorëve në dispozicion (% e mirë ose shumë e mirë)	I1G	80.5%	78.1%- 83.1%	Min	2%	Shterpce
				Mediani	85%	Klina
				Maks	98.50 %	Gjakova
Cilësia e fuqisë punëtore kënaq të gjitha nevojat e kompanisë (% po)	I10	38%	35%- 41.5%	Min	0%	Mamushe & Shterpce
				Mediani	27%	Decan, Glllogovc, Vushtrri
				Maks	78%	Kacanik
Shërbime të rregullta këshilluese janë në dispozicion në komunë (% po)	I11A1	20%	17%- 22.5%	Min	0%	Gjakova, Gracanica, Klllokot, Mamushe Decan & Fushe Kosova
				Mediani	19%	
				Maks	94%	Istog
Një sërë shërbimesh mbështetëse për bizneset është në dispozicion në komunë (% po)	I11B1, I11E1, & I11F1	20%	17.5%- 22%	Min	0%	Gracanica, Mamushe, Prizren
				Mediani	14%	Junik & Prishtina
				Maks	92%	Klllokot

8. INFRASTRUKTURA KOMUNALE

Infrastruktura nuk matet zakonisht në IQE-të e tjera. Megjithatë, kjo është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën për shkak të nivelit të ulët të infrastrukturës aktuale të vendit dhe efektet afatshkurtra të theksuara të përmirësimeve pasuese. Në të vërtetë, infrastruktura në Kosovë vazhdimisht renditet si një nga pengesat më të mëdha për biznesin.⁵⁹ Infrastruktura e vendit ishte e shkatërruar nga lufta dhe për shkak të mos investimeve me dekada, dhe vazhdon të jetë në nevojë urgjente për riparim. Rrugët e paasfaltuara përbëjnë gati 90% të nën-rrjetit të rrugëve lokale, dhe

⁵⁹ Shih Bërjen e Biznesit të Bankës Botërore (2010) dhe Anketës së Ndërmarrjeve (2009).

krahasuar me rrjetet rajonale rrugore, Kosova mbetet pothuajse prapa të gjithë fqinjëve të saj rajonalë.⁶⁰ Derisa janë duke u zbatuar planet e infrastrukturës rrugore në nivel qendror në tërë vendin, progresi është i ngadalshëm dhe kontratat e ndërtimit janë të diskutueshme. Në nivel nën-kombëtar, komunat janë përgjegjëse për zhvillim dhe investime në rrjetet e rrugëve lokale, si dhe shërbime të tjera publike, duke përfshirë ujë dhe kanalizimin. Mbi tre të katërtat e rrjetit rrugor janë nën përgjegjësinë e komunave dhe aty është i dukshëm mos investimi, pasi që nevoja të shumta konkurrojnë për fonde të kufizuara komunale. Në veçanti, fondet për mirëmbajtje kanë tendencë që të jenë të pamjaftueshme apo në vartësi të projekteve të ndërtimit të ri.⁶¹ Për bizneset, cilësia e dobët e rrugëve çon në kosto më të larta të transportit në sjelljen e produkteve në treg, për shkak të kohës që duhet për të bartur mallrat, si dhe koston e mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve të dëmtuara nga rrugët e këqija.

Urgjenca e investimeve në infrastrukturë dhe baza e ulët prej nga ajo fillon, mundësojnë përmirësime të rëndësishme në mjedisin e biznesit në një periudhë të shkurtër kohore. Pa përmirësime të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore, si në nivel kombëtar dhe lokal, koston dhe rreziqet për investimet dhe zhvillimin e biznesit në Kosovë do të vazhdojnë të vështirësohen. Në të vërtetë, nevojiten investime të konsiderueshme për të sjellë infrastrukturën e transportit deri në standardin e nevojshëm për rritje të qëndrueshme.⁶²

Në aspektin e furnizimit me ujë, bizneset në shumë komuna vazhdojnë të përballen me koston e furnizimit jo të besueshëm dhe me ndërprerje me ujë. Për firmat prodhuese, ndërprerjet e ujit mund të shkaktojnë shpenzime të mëdha për biznesin, dhe kështu imponojnë një barrë të konsiderueshme për të bërë biznes. Edhe pse furnizimi me ujë ofrohet kryesisht në nivel rajonal, dhe ofrimi i një shërbimi të tillë është i përshtatshëm dhe logjik, ka variacione të konsiderueshme në qëndrueshmërinë e rrjedhës së ujit që është shpesh e lidhur me mbledhjen faturave të ujit. Me përgjegjësinë për sigurimin e ujit në duart e komunave, udhëheqësit lokal mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e ofrimit të furnizimit me ujë në lokalitetet e tyre duke punuar në shkallën e arkëtimit të pagesave të ujit për ofruesin e shërbimit të furnizimit me ujë, si mekanizëm kyç për përmirësimin e rregullsisë dhe furnizimit me ujë.

Në renditjen e përgjithshme të nën-indeksit, Istogu (9,18) paraqet veten si lider i qartë, i ndjekur nga Gjilani (8,75), në vendin e dytë. Vushtrria (2,66) renditet i fundit, me Shtërpçën (3,54) dhe Kllokotin (3,39) ku së bashku renditen në fund të renditjes.

⁶⁰ Shih Banka Botërore (2007).

⁶¹ Banka Botërore (2010).

⁶² Shih Raportin e Vlerësimit të Performancës Ekonomike (2008)

Figura 4.18: Renditja e nën-indeksit të infrastrukturës komunale





Figura 4.19: Nën-indeksi i infrastrukturës komunale me 95% të intervalit të besimit



Nën-indeksi i infrastrukturës komunale në mënyrë specifike mat vetëm infrastrukturën që bënë pjesë në kuadër të juridiksionit direkt dhe të autoriteteve komunale. Dy indikatorët e parë masin cilësinë e mirëmbajtjes së rrugëve komunale dhe ndërtimit të tyre, si dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve me ujë dhe të kanalizimit. Indikatorët e tretë dhe katërt vlerësojnë shërbimet e furnizimit me ujë, së pari nëpërmjet një indikatorit që mat shkallën e mbledhjes së faturave të ujit (si një prokurë për shkallën e rrjedhjes dhe disponueshmërisë së ujit), si dhe së dyti nëpërmjet mesatares së orëve të ndërprerjes së furnizimit me ujë për një muaj me të cilat përballen firmat.

Tabela 4.9: Treguesit që përfshijnë nën-indeksin e infrastrukturës komunale

Indikatori	IKK Pyetja	Mesatarja Kombëtare	KK-të Kombëtare 95%	Rezultatet Komunale	Rezultati	Komuna
Cilësia e mirëmbajtjes dhe ndërtimit të rrugëve (% e mirë ose shumë e mirë)	1A & 11B	65%	62%-29%	Min	2%	Shterpce
				Mediani	68%	Prizren
				Maks	97%	Istog
Cilësia e shërbimeve sanitare , të mbeturinave dhe ujësjetësimit (% e mirë ose shumë e mirë)	11D & 11E	72%	69%-75%	Min	2%	Shterpce
				Mediani	71%	Pristina
				Maks	97.5%	Mamushe
Ofruesit e shërbimeve inkasojnë 100% të tarifave të ujit nga bizneset (% shpesh ose gjithmonë)	14	39%	36%-42%	Min	0%	Mamushe & Kllokot
				Mediani	34%	Podujeva
				Maks	91%	Mitrovica
Meatarisht sa orë pa ujë në muaj	12	18	15-20	Min	0	Gjakova
				Mediani	22	Kllokot
				Maks	119	Mamushe

5. MJEDISI KOMBËTAR I BËRJES BIZNES DHE KORRUPSIONI

Rregulloret dhe procedurat për të nisur një biznes në Kosovë qeverisen dhe administrohen në nivel kombëtar. Anketa e IKK ka parashtruar një numër pyetjesh për bizneset që lidhen me fillimin e biznesit. Rezultatet kombëtare për disa nga komponentët më të rëndësishme dhe të zakonshme janë paraqitur në tabelën 5.1 më poshtë. Pasi që firmat në të gjithë sektorët dhe të gjitha llojet e subjekteve juridike janë anketuar, këta tregues mund të jenë të dobishëm qoftë vetëm ose si një plotësues të sondazheve të tjera kombëtare dhe raporteve të tilla si Raporti e Bankës Botërore për *Bërjen Biznes*, ose anketat e ndërmarrjeve. Për të dhënë disa krahasime fillestare, dy kolonat e fundit në tabelën 5.1 më poshtë lidhin rezultatet e IKK për Prishtinën dhe rezultatet e raportit *Bërja Biznes*. Rezultati mesatar kombëtar sipas SHPK dhe rezultateve të IKK për Prishtinën janë paraqitur si shtesë për mesataren kombëtare, pasi që rezultatet e Bërjes Biznes reflektojnë mjedisin e biznesit në Prishtinë për SHPK-të. Një shënim i fundit kur bëjmë krahasime mes këtyre dy masave është dallimi në metodologji, ku IKK ofron një masë *de faktor* në vend se një masë *de jure* të mjedisit të biznesit. Treguesit kanë të bëjnë me fillimin e një biznesi, qasjen në financa, dhe masat përkatëse për të operuar një biznes i tillë siç janë marrëdhëniet me Administratën Tatimore.

Tabela 5.1: Kostoja kohore dhe monetare e Bërjes Biznes

Indikatori	IKK Pyetja	Mesatarja Kombëtare	IKK Rezultati për Prishtinë	Rezultati i veprimtarisë së biznesit (SHPK)
Kostoja Kohore dhe Monetare				
Ditët e nevojshme për të regjistruar biznesin	B2	11 (SHPK=8.5)	7	10
Ditët e nevojshme për të marrë numrin fiskal	C3B	10 (SHPK=11)	13	7
Kostoja e numrit fiskal (Euro)	C3C	9		
Kostoja për të marrë lejen komunale për punë (Euro)	C2C	79		
Ditët e nevojshme për të marrë lejen komunale për punë	C2B	11 (SHPK=10)	9	30
Ditët e nevojshme për të marrë çertifikatën për TVSH	C4B	10.5 (SHPK=11)	13	7
Kostoja për të marrë çertifikatën e TVSH-së	C4C	13		
Ditët për të marrë lejen e ndërtimit	C6B	17	<i>Nuk vlen</i>	30
Kostoja për të marrë lejen e ndërtimit (Euro)	C6C	174	<i>Nuk vlen</i>	13,007
Numri i licencave, lejeve dhe çertifikave të nevojshme për funksionimin e biznesit	C1	3		
Tatimet anësore paraqesin ngarkesë të madhe ndaj regjistrimit të bizneseve të reja (% fuqimisht pajtohem ose pajtohem)	G6	85%		
Qasja në Financa				
Qasja në financa paraqet pengesën më të rëndësishme ndaj nisjes së një biznesi (% po)	B5A	33%		
Qasje e lehtë ose shumë e lehtë në informata për kredi ose financa (% po)	E1F	29%		
Bizneset kanë qasje në historitë e kreditit (% pajtohem ose fuqimisht pajtohem)	L4B	43%		
Bizneset kanë mbështetje në qasjen ndaj kredive (% pajtohem ose fuqimisht pajtohem)	L4C	54%		
Ofrimi i dhuratave ose tarifave shtesë për zyrtarët kreditor është e shpeshtë për të marrë kredi (% pajtohem ose fuqimisht pajtohem)	L4D	27%		
Administrata Tatimore				
Numri i inspektiveve nga autoriteti tatimor	F4	2		
Kohëzgjatja mesatare e inspektiveve tatimore (në orë)	F5	2		
Përqindja e shitjeve që bizneset llogarisin në raportet tipike për qëllime të tatimit	G4	60%		

*Për të ulur ndikimin e rezultateteve të larta të veçuara, për të gjithë indikatorët pa përçindje, përgjegjet maksimale janë modifikuar në përçindjen e 90-të të rezultatit.

KORRUPSIONI

Pengesat institucionale për të bërë biznes, duke përfshirë edhe korrupsionin e perceptuar në qeveri, janë faktorë përcaktues të zhvillimit të sektorit privat dhe perspektivat për rritje të qëndrueshme.⁶³ Korrupsioni në Kosovë ka krijuar një fushë të padrejtë të hapësirës së zbatimit jokonsistent dhe të paparashikueshëm të rregullave të tregtisë dhe biznesit dhe, duke bërë të mundshme për disa biznese që t'iu shmangen taksave, kufizimeve të licencimit, apo detyrimeve doganore që të tjerët duhet t'i paguajnë. Në vitin *Indeksin 2010* të Transparency International për *Perceptimin e Korrupsionit*, Kosova renditet e fundit midis vendeve të anketuara në rajon. Globalisht, Kosova renditet e 110 në shkallën e perceptuar të korrupsionit.⁶⁴ Korrupsioni gjithashtu renditet i lartë në mjedisin e pengesave të biznesit sipas perceptimeve të firmave në kuadër të Anketës së Ndërmarrjeve 2009 për Kosovën. Firmat e anketuara tregojnë se korrupsioni është shumë afër pas furnizimit me energji elektrike, si pengesa më serioze që prek aktivitetet e biznesit.⁶⁵

Korrupsioni sistematik dhe mungesa e transparencës në procesin e tenderimit publik godasin mjedisin e biznesit konkurrues dhe të barabartë.

Zvogëlimi i korrupsionit, jo vetëm që zvogëlon koston monetare, por edhe rrezikun e të bërit biznes, dhe rrit parashikueshmërinë e mjedisit në të cilin operon biznesi.⁶⁶ Duke përmendur mungesën e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin, Raporti 2010 i Freedom House *Kombet në Tranzicion* vazhdon të rendit Kosovën në nivelin 5.75 për shkallën e tij prej 7 pikësh, ku numri 7 paraqet vendet më të korruptuara. Kosova ka mbajtur këtë rezultat të dobët që nga viti 2008.⁶⁷

Në vende të tjera, ku janë kryer indekset e tilla, një nën-indeks kyc ka të bëjë me akuzat informale dhe korrupsionin, që mat perceptimet mbi nivelet e korrupsionit, parashikueshmërisë së korrupsionit, dhe nëse ajo të çon në shërbimet e kërkuara apo jo. Derisa ky nën-indeks ishte paraparë për përfshirje në IKK, normat e përgjigjeve nga biznesi në anketë për këto pyetje ishin shumë të ulëta në tërë bordin. Prandaj, ne nuk kemi informacion të mjaftueshëm për përfshirjen e tij. Në fakt, ky nivel i ulët i mos-përgjigjeve në komponentin e korrupsionit të anketës ishte fusha e vetme ku normat e mos-përgjigjeve të nivelit komunal ishin aq të ulëta sa që ato shtyn që të përjashtohen këta tregues nga IKK.

Megjithatë, kjo shkallë e ulët e përgjigjeve në mënyrë unike lehtëson një analizë të korrupsionit në nivel kombëtar dhe madje edhe në nivel nën-kombëtar. Mos-përgjigjet e bizneseve në lidhje me pyetjet e korrupsionit qoftë duke u shprehur 'nuk e di' apo 'duke refuzuar të përgjigjen' mund të konsiderohet si tregues i një mjedisi më pak transparent, më të mbyllur, dhe të korruptuar. Përveç kësaj, kur përgjigjet kryesisht anonin kah një mjedis më i ulët i korrupsionit, ne mund t'i kryqëzojmë këto përgjigje me masa të tjera të korrupsionit në vend. Nëse përgjigjet nuk janë

⁶³ Shih Vlerësimin e performancës ekonomike (2008).

⁶⁴ Shih Transparency International (2010).

⁶⁵ Shih Banka Botërore dhe IFC (2009).

⁶⁶ Shih Zyrën e Rritjes ekonomike (2007).

⁶⁷ Shih Deda, Ilir (2010).

pasqyruese të këtyre masave të tjera, kjo mund të ilustrojë atë që ne mund ta quajmë një “përgjigje të rreme”, ku një i anketuar me vetëdije të plotë jep një përgjigje të rreme për shkak të natyrës së ndjeshme të një pyetjeje dhe frikës të lidhur direkt me një përgjigje.⁶⁸

Një metodologji inovative ka përparuar që propozon vlerësimin e niveleve të korrupsionit që ekziston në një vend nëpërmjet përdorimit të një norme të artikullit të tillë (pyetjeve) pa përgjigje dhe të normave të përgjigjeve të rreme.⁶⁹

Autorët e kësaj metodologjie të re parashtrojnë se brezi i mos-përgjigjeve dhe përgjigjeve të rreme është një funksion i mjedisit politik në të cilin firmat veprojnë, dhe kanë konstatuar se pas mbledhjes së të dhënave mbi ndikimin e përgjithshëm të pyetjes së korrupsionit nga *Anketa e Bankës Botërore mbi Produktivitetin dhe Klimën e Investimeve dhe Ndërmarrjeve Private (PICS)* që në vendet me liri të kufizuar të shtypit, firmat kanë më shumë gjasa për të ofruar mos-përgjigje apo përgjigje të rreme për çështjet e korrupsionit, prandaj në fakt edhe zvogëlojnë shkallën e korrupsionit në vend.⁷⁰

Duke pasur parasysh këtë studim dhe renditjen e dobët të Kosovës nga Transparency International CPI në vendin 110 globalisht dhe të fundit në rajon, ne mund të parashikojmë se ashpërsia e korrupsionit me gjasë është nënçmuar si me mos-përgjigjet po ashtu edhe me përgjigjet e rreme në pyetjet e korrupsionit në anketën e IKK-së. Tabelat e mëposhtme paraqesin disa nga pyetjet e anketës së IKK që kanë adresuar aspektet e korrupsionit dhe normat e tyre përkatëse të mos-përgjigjeve dhe përgjigjeve të rreme.

Tabela 5.2: Përgjigjet potencialisht të rreme & shkalla e mos-përgjigjeve

Indikator	IKK Pyetja	% e Kompanive që përgjigjen me Po	% e Kompanive që përgjigjen me Jo	% e Kompanive që nuk përgjigjen fare (nuk e dijnë/refuzojnë të përgjigjen)
Kompanitë paguanë disa pagesa të parregullta jo-zyrtare	K1	12%	57%	31%

Tabela 5.2 ilustron përqindjet për firmat që janë përgjigjur, si dhe për ato që nuk janë përgjigjur një pyetje për korrupsion. Përqindja e firmave që kanë raportuar për disa kryerjen e disa pagesave të parregullta jozyrtare është shumë e ulët, në 12 %. Kjo shifër është shumë më e ulët se në përgjigjet e anketave të vetë-raportimit në hulumtimet e kryera në pjesën më të madhe të Evropës Lindore dhe Qendrore si dhe në rajonin e Azisë Qendrore të firmave që kryejnë pagesa të parregullta jozyrtare, në 23,52 %.⁷¹

⁶⁸ Me përgjigje të rreme nënkupton të njëjtin kuptim si 'respondent fjalëpakë' në Azfar dhe Murrell (2009, 338)

⁶⁹ Shih Jensen, Li, dhe Rahman.

⁷⁰ Ibid. Pyetja specifike është: " Ju lutem na tregoni nëse korrupsioni është një problem për funksionimin dhe rritjen e biznesit tuaj. Nëse korrupsioni përbën një problem, ju lutemi a e gjykoni ashpërsinë e saj si një pengesë në një shkallë prej pesë pikësh..."

⁷¹ Shih IFC dhe Anketa e Ndërmarrjeve e Bankës Botërore (2005-2010).

Tabela 5.3: Normat e njësisë së mos-përgjigjeve sipas komunave

Pyetja (K1)	Shkallët e mos-përgjegjeve komunale mbi 50%	Shkalla e mos-përgjegjeve
Kemi gjetur që kompanitë ndonjëherë kërkojnë të bëjnë dhurata ose pagesa të pa-rregullta jozyrtare për zyrtarët komunal në mënyrë që të kryejnë punët përkitazi me tatimet, lejet, rregulloret, fitimin e tenderëve komunal, ose për të fituar shërbime komunale. A është kjo e shpeshtë për kompanitë në linjën tuaj të biznesit, që të paguani pagesa të pa-rregullta jo-zyrtare?	Gracanica	82%
	Hani i Elezit	58%
	Kamenica	70%
	Klina	58%
	Klllokot	96%
	Obliq	68%
	Peja	71%
	Rahovec	77%
	Shterpce	70%
	L-ZP-Zvecan	65%

Tabelat 5.3 dhe 5.4 tregojnë nivelet e larta të mos-përgjigjeve në dy pyetje të ndjeshme të korrupsionit. Mbi 50 % është konsideruar këtu të jetë një shkallë e lartë e njësisë së mos-përgjigjeve në nivel komunal. Tabelat 5.3 dhe 5.4 tregojnë normat veçanërisht të larta të mos-përgjigjeve në disa komuna që kanë popullsi të biznesit të vogël, të tilla si Klllokoti dhe Mamusha. Përveç kësaj, Hani i Elezit është veçuar për frekuencën e tij të lartë të mos-përgjigjes në të dy pyetjet.

Tabela 5.4: Normat e njësisë së mos-përgjigjeve sipas komunave

Pyetja (K5)	Shkallët e mos-përgjegjeve komunale mbi 50%	Shkalla e mos-përgjegjeve
Nëse një firmë bën një pagesë shtesë, ose i jep dhuratë një zyrtari komunal për të fituar një shërbim komunal, sa shpesh ndodh që shërbimi të fitohet siq ishte pritur?	Fushe Kosovo	67%
	Hani i Elezit	60%
	Malisheva	62%
	Mamushe	98%
	Skenderaj	55%

Derisa prezantimi i këtyre normave të njësisë së mos-përgjigjeve dhe përgjigjeve potencialisht të rreme nuk është aspak bindës, kjo ndjeshmëri në pyetjet e korrupsionit sugjestion më shumë për një mjedis politikisht represiv. Në të vërtetë, Liria e Shtypit 2011 e Freedom House duke e renditur Kosovën si vend pjesërisht të lirë (apo pozita 51 në një shkallë nga 0=lirë për 100=Nuk ka liri), duke e vendosur në vendin e 104 nga 196 vende.⁷²

Punë e konsiderueshme është e nevojshme në mënyrë që të krijohet një mjedis i biznesit që do të stimulojë investimet, produktivitetin dhe rritjen ekonomike.

⁷² Shih Freedom House (2011).

Prevalenca e korrupsionit paraqet një pengesë të konsiderueshme për këtë. Qeveria dhe donatorët duhet të marrin parasysh jo vetëm reformimin e mjedisit ligjor dhe rregullator, por edhe përmirësimin e kapaciteteve qendrore dhe nën-kombëtare për të zbatuar reformat e tilla në mënyrë që të zvogëlohen kanalet e korrupsionit.⁷³ Treguesit dhe vlerësimi nga IKK mund të sigurojë informacion të vlefshëm se ku dhe si mund të adresohen përmirësimet strategjike të qeverisjes dhe kapaciteteve të qeverisë. Më tej, ky rishikim i përciptë e përgjigjeve për pyetjet e korrupsionit në anketën e IKK-së potencialisht mund të përdoret për të siguruar njohuri fillestare se ku mund të jenë më të larta nivelet e korrupsionit ose ku firmat ndejnë rrezik të lartë për të qenë të identifikuar për përgjigjet e tyre në pyetjet e ndjeshme në lidhje me korrupsionin

⁷³ Shih Vlerësimi i Performancës Ekonomike USAID (2008).

6. METODOLOGJIA

Në këtë kapitull përfundimtar, ne japim një pasqyrë të metodologjisë specifike të përdorur për të zhvilluar IKK. Viti i parë i një ndërmarrjeje të tillë në një vend të ri është e detyruar të jetë sfiduese dhe komplekse pasi që metodologjia është përshtatur me kujdes që të përputhet me rrethanat lokale. Është ndërmarrë cdo kujdes për të siguruar sa më shumë që është e mundur një metodologji që është e drejtë dhe statistikisht rigorozë. Megjithatë, ka gjithmonë vend për përmirësim. Të kuptuarit e qartë të metodologjisë është vendimtare për zhvillimin dhe përmirësimin e IKK në të ardhmen, pasi që komentet për qasjen tonë ndihmon të sigurojmë që IKK bëhet më relevante dhe e vlefshme për Kosovën dhe për ata që do ta shfrytëzojnë atë.

Për më tepër, ofrimi i qartësisë mbi metodologjinë është një çështje e të qenit fer. Në nivelin më themelor, IKK është një tabelë e notave të performancës së qeverisë lokale në baza vjetore, dhe është e drejtë vetëm nëse shpjegohet se pse dhe si ata që kanë performancë të mirë apo jo edhe aq të mirë kanë marrë notat që i kanë. Të kuptuarit se si janë nxjerrë rezultatet gjithashtu është vendimtare për hartimin e politikave që mund të ndihmojnë të përmirësojnë mangësitë e qeverisë të identifikuar në Indeks.

PASQYRA E MOSTRAVE

Indeksi i Konkurrencës në Komuna aplikon një strategji të shtresuar të rastit për marrjen e mostrave për të zgjedhur mostrën e bizneseve për anketë. Kjo qasje siguron që mostrat e komunës janë një pasqyrim të saktë të popullsisë së komunës. Nga popullata e biznesit, komponentët kryesorë të sektorit dhe të tipit juridik janë pasqyruar sa më saktë që është e mundur në mostër. Për ta bërë këtë, janë krijuar shportat e popullsisë kritike dhe brenda këtyre shportave është kryer marrja e mostrave në mënyrë të rastësishme.

Së pari, ne kemi ndërtuar 37 shtresa të ndara të nivelit komunal. Së dyti, firmat janë grupuar në dy karakteristika, sipas tipit të subjektit juridik (1=pronësia personale, 2=SHPK, 3=Partneritete, shoqëri aksionare, dhe subjektet e jashtme) dhe sipas sektorit (1=Tregtia, 2=Shërbime, 3=Prodhim & ndërtim, 4=Burimet Natyrore & Bujqësia). Është aplikuar strategjia e rastit e marrjes së mostrave brenda secilit prej këtyre shportave për të siguruar se mostra e firmave pasqyron strukturën e popullatës komunale sa më shumë të jetë e mundur. Të dhënat nga anketa për këtë arsye janë një përshkrim përfaqësues i perceptimeve të fuqishme të mjediseve ekonomike në të cilat ata punojnë. Aty ku firmat në mostër ishin jo aktive, të mbyllura, ose pa informacion të saktë kontakti, një tjetër firmë nga lista e dytë e mostrës ishte zgjedhur rastësisht nga shporta e njëjtë. Më tej, nëse një firmë ka refuzuar të përgjigjet, kjo është nënvizuar, dhe një tjetër firmë ishte zgjedhur rastësisht. Përqindja e përgjithshme ka qenë mesatarisht 77 % në të gjitha komunat, me vlerën më të lartë prej 100 % dhe ajo më e ulët prej 63 %.

QASJA E ANKETËS

Anketa është zbatuar përmes intervistave ballë-për-ballë me pronarët e bizneseve në gjuhën e tyre. Nëpërmjet anketimit të bizneseve personalisht dhe jo nëpërmjet intervistave telefonike ose përmes postës elektronike, ne ishim në gjendje për të shmangur të shkallën e lartë të pashmangshme të mos-përgjigjeve. Bizneset së pari janë kontaktuar nëpërmjet një thirrje shqyrtuese për të përcaktuar të kualifikueshmërinë e tyre (aktive) dhe të caktojnë një orar për intervistë. Në mënyrë për të minimizuar ndikimin e efekteve të "trajtimit" të ri që rezultojnë nga anketuesit e ndryshëm, anketuesit u trajnuan rigorozisht në lidhje me anketën, metodologjinë e IKK, dhe arsyet që qëndrojnë prapa IKK-së, për të kufizuar mundësinë për njëanshmëri të anketuesve në përgjigjet e dhëna.

Mbikëqyrësit me përvojë të punës në terren kanë zbatuar kontrole në terren dhe kontrollin e cilësisë në të gjitha anketat e kryera dhe aty ku pasimi ishte i nevojshëm apo u shfaqën problemet, regjistruarit u kthyen tek të anketuarit për sqarime ose korrigjime.

INSTRUMENTI I ANKETËS

Një instrument i anketës është zhvilluar posaçërisht dhe iu është përshtatur mjedisit të biznesit të Kosovës, por reflekton ngjashmëri me shumë pyetje në anketat e e përdorura në IQE-të e tjera. Pasi plotësimi të instrumentit të anketës, ai i është nënshtruar përkthimit qarkor (anglisht-shqip-anglisht/anglisht-serbisht-anglisht) për të siguruar që kuptimi i pyetjeve ishte ruajtur edhe në përkthim. Protokollin e anketës është subjekt i testimit rigoroz për të siguruar që pyetjet përfshijnë komponentët kryesorë të mjedisit të biznesit, që ishte i kuptueshëm dhe i mundshëm për pronarët e bizneseve për t'u përgjigjur në të, si dhe instrumenti i anketës ishte dizajnuar në mënyrë adekuate që të zbatohet nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Anketa është testuar paraprakisht në tri grupet e fokusit me pronarët e bizneseve në Prishtinë, Klinë dhe Graçanicë, e ndjekur nga një test pilot me 20 biznese të zgjedhura rastësisht në Leposaviq, Ferizaj dhe Vushtri. Hulumtimi është kryer në gjuhën shqipe dhe serbe.

KRIJIMI I INDEKSIT

IKK ndjek nga afër metodologjinë e Indeksit të Qeverisjes Ekonomike. Metodologjia përfshin tri elemente kryesore të Mbledhjes, Ndërtimit dhe Kalibrimit. Mbledhja përfshin përzgjedhjen e indikatorëve më relevantë për qeverisjen nën-kombëtare, pas një shqyrtimi të plotë teorik përkatës, dhe literaturës specifike të vendit, si dhe biseda të hollësishme me ekspertë dhe praktikantë në çdo vend. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar që treguesit pasqyrojnë vendimet politike dhe opsionet për zbatim të ndërmarra nga udhëheqësit e nivelit nën-kombëtar. Vlerësimi i lokaliteteve i bazuar në politikat kombëtare rregullative ose institucionet e kontrolluara nga burokracia kombëtare nuk është vetëm jo adekuat, por ofron variancë të vogël për matjen e performancës relative të nivelit nën-kombëtar. Është gjithashtu e rëndësishme që treguesit të paraqesin informacion të dobishëm për

udhëheqësit lokalë. Për shembull, një notë e ulët për "procedurat e rënda administrative" nuk është edhe aq menjëherë e dobishme si një mesazh ku periudha mesatare e pritjes për të marrë një leje pune është dy herë më e madhe sesa mostra mesatare. Ndryshe nga disa qasje të tjera të indeksimit, treguesit nuk janë grupuara sipas korrelacioneve statistikore.

Treguesit janë zgjedhur për të pasqyruar masat më të përshtatshme të koncepteve kryesore teorike të qeverisjes. Shporta e treguesve që përfshijnë konceptet shndërrohet në nën-tregues. Ndonjëherë shportat e treguesve janë shumë të përgjithshme për të përfshirë koncepte e nuancuara. Në këto raste, nën-indekset janë ndarë më tej në dimensione. Zgjedhja e nën-indekseve dhe treguesve fillon gjatë një periudhe dy-mujore që përfshin hulumtimin teorik në zyra dhe atë në terren në Kosovë, intervistimin e bizneseve, shoqatat e biznesit, zyrtarë të qeverisë, kryetarët e komunave, drejtorët e departamenteve komunale dhe agjencitë, donatorët, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë.

DIAGNOZA E TREGUESIT

Pas mbledhjes së të dhënave të anketës dhe pasi që të konsolidohen dhe janë të gatshme për analizë, hapi i dytë i këtij procesi është identifikimi i masave për t'i përfshirë në IKK. Si të tillë, treguesit duhet të kalojnë një numër të testeve statistikore. Së pari, gabimet standarde rreth çdo agregati komunal duhet të jenë mjaft të vogla, në mënyrë që rezultatet e komunave në 75 përqindëshin ose një tregues i veçantë të dallojnë në mënyrë të konsiderueshme nga komunat në 25 përqindësh, të tilla që intervalet e besimit rreth dy rezultateve të mos duplikohen. Ky test është i rëndësishëm në mënyrë që nëse indeksi duhet të përsëritet në 100 mostra të ndara, 95 nga ato raste, komunat e njëjta do të vendosen në fund të nivelit më të lartë dhe në fund të nivelit më ulët të një rezultati të veçantë. Kjo siguron fuqinë e renditjes nga viti në vit, dhe eliminon mundësinë që një mostër e re do të gjenerojë renditje të ndryshme komunale.

Testi i dytë kërkon që diferencat në përgjigjet komunale nuk janë shkaktuar kryesisht nga variacioni në sektorin e firmës ose llojit të subjektit juridik, ashtu siç është identifikuar nëpërmjet analizës regressive. Aty ku kjo ishte e pranishme në një sërë treguesish, për të cilat është konstatuar korrelacioni diferencial i llojit të subjektit juridik, vetëm pronësia personale janë përfshirë në rezultatet. Kjo siguron që pikët janë të drejta, të tilla që aty ku komunat mund të kenë një përqindje më të madhe të SHPK, shoqëri aksionare, ose partneriteteve, komunat nuk janë ndëshkuar padrejtësisht ose përkundrazi nuk janë shpërblyer për këtë.

